

Dëlirje & Edukim

GUSHT 2009, MUAJI I RAMAZANIT / NR. 4 / QMIMI I C

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE

Muaji i Ramazanit dhe Tevhidi Editoriali Fq. 2

Si duhet ta presim Ramazanin?

"Ramazani pritet me pendim, sinqeritet,
durim, adhurim, falje etj." fq. 5

O Kërkues i së mirës, Nxito

"Përgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem
thotë: "Kur të vijë nata e parë e muajit të
Ramazanit, hapen dyert e xhenetit dhe
mbyllen dyert e xhehenemit, shejtanët
lidhen me pranga, dhe një thirrës thërret:
"O kërkues i së mirës, nxito (kah ajo) dhe o
kërkues i të ligës (mëkatit) ndalo (largohu
nga ajo). Allahu për do natë liron njerëz
nga zjarri i xhehenemit." fq. 9

Këshilla e muajit

Allahu thotë në hadithin Kudsij:
"Agjërimi bëhet vetëm për Mua, andaj vetëm Une
shpërblej për të."

edicion
special
për
Ramazan

MUAJI I RAMAZANIT DHE TEVHIDI

E falënderojmë Allahun e Madhëruar që na ka udhëzuar në këtë Islam plot begati e mirësi, Islam i pastrimit shpirtëror përpara atij fizik. Prej mirësive apo prej të mirave të kësaj feje është edhe agjërimi i muajit të shenjtë të Ramazanit, i cili e gdhend dhe e kalit shpirtin e njeriut, e dëlir atë nga mbeturinat e mëkateve, i jep stil dhe etikë dinjitetit njerëzor dhe e bën atë human e të çiltër si me Zotin e tij edhe me vetveten dhe shoqërinë. Ky muaj e afron njeriun pranë pedestalit më të lartë të rehatisë shpirtërore, rehati e cila do të ishte blerë shtrenjtë nga të huajt dhe ata të cilët nuk e kanë shijuar ndjenjën e të qenët pjesëmarrës të të mirave të këtij muaji.

Agjërimi i Ramazanit e çliron njeriun nga robëria e botës materiale, nga epsheet shtazarake dhe e bën vetëm rob të Allahut, duke mbjellë në shpirtin e tij njësimin e Allahut, i cili është qëllimi për të cilin janë krijuar njerëzit dhe xhinët. Njëkohësisht, jetësimi i Ramazanit me të gjitha rregullat e tij ka si qëllim kryesor që njeriu shpirtin e vet t'ia dorëzojë Krijuesit, të krijojë lidhjen më të fortë që ekziston mes robit dhe Allahut dhe kështu të realizohet qëllimi i krijimit të njeriut.

Pse themi kështu?

Sepse Allahu i Madhërishtëm i ka dërguar Pejgamberët te njerëzit që t'ua mësojnë atyre tevhidin, besimin e drejtë dhe praktikimin e shariateve, mirëpo nuk duhet harruar një gjë, se vetë praktikimi i shariatit nënkupton domosdoshmërisht edhe zbatimin e tevhidit, njësimin të Allahut me tërë atë që meriton. Praktikimi i shariatit duhet bërë vetëm për Allahun dhe që t'ia afrohem Atij sa më shumë, që të arrijmë kënaqësinë e Tij. Pasi është kështu, atëherë zbatimi i shariatit gjithësesi është njësim i Allahut dhe për këtë falënderimi i takon vetëm Allahut!

Sigurisht që agjërimi i Ramazanit me të gji-

tha rregullat që përmban është pjesë e këtij sheriati, për të cilën jemi duke folur. Kjo do të thotë se agjërimi i Ramazanit në mënyrën më të drejtë e më të përsosur nënkupton patjetër njësimin e Allahut me të gjitha meritat dhe të drejtat sublime që i takojnë. Dhe sikur për agjëruarit të mos kishte mësim tjetër nga agjërimi i këtij muaji përveç këtij, do të kishte mjaftuar sepse nëse agjëruari i Ramazanit realizon me të tevhidin, atëherë ka korrur sukses në realizimin e qëllimit kryesor nga shkolla edukative, shkolla e Ramazanit. E si mos të jetë kështu kur agjërimi është vetëm për Allahun, i Cili është i vetmi që e di gjendjen reale të agjëruarit dhe ka thënë: “Agjërimi bëhet vetëm për Mua, andaj vetëm Unë shpërblej për të.”

Vetëm Ai e di çiltërsinë dhe dëlirjen e zemrave tona në luftën për të qenë robër vetëm të Allahut deri në vdekje, në luftën për të qenë muvahidë të vërtetë, pasi shpëtimi në ahiret nuk arrihet ndryshe vetëm se kështu e jo duke qenë robër të epsheve, të tekave, të famës e pozitës, të botës materiale dhe zburimeve.

O Allahu im! Mos na i merr shpirtrat ndryshe vetëm se duke qenë muvahidë të vërtetë, të sinqertë e të denjë në veprat e fjalët tona dhe ruana nga shirku në cilindo lloj adhurimi, qoftë nga ai që e bëjmë me vetëdije apo pa vetëdije!

O Allahu im! Bëje këtë muaj pastrim të shpirtit dhe të veprave tona, e pastrimi më i mirë është realizimi i tevhidit!

O Allahu im! Na fal ne, prindërit tanë dhe familjet tona, na përmirëso qëllimet tona dhe na bëj nga prijësit e të devotshmëve!

Ti je Ai që i dëgjon lutjet tona dhe u përgjigjesh atyre!

Amin!

Kryeredaktori

PËRGËZIME PËR ARDHJEN E MUAJIT TË BEKUAR RAMAZANIN

O ju njerëz, kini frikë Allahun dhe dijeni se është obligim i çdo muslimani ta adhurojë Allahun dhe ta respektojë gjatë gjithë jetës së tij. Allahu në Kur'an thotë: "Adhuroje Zotin tënd derisa të vijë vdekja." Disa nga selefët kanë thënë se "vepra e muslimanit nuk ka kuptim pa vdekje".

S'ka dyshim se muslimani i shfrytëzon stinët e të mirave për adhurime dhe aktivitete të dobishme. E nga këto stinë me të mira është edhe muaji i Ramazanit, në të cilin zbriti Kur'ani. Ky është mysafiri i bereqetshëm, të cilin muslimanët e presin me padurim, duke falënderuar Allahun që ua mundësoi ta përjetojnë dhe duke kërkuar nga Allahu që t'ua lehtësojë adhurimet dhe punët e mira në të. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka lutur Allahun për ardhjen e Ramazanit. Disa muslimanë këtë muaj e

njohin vetëm si muajin e ushqimeve, duke bërë harxhime të shumta në blerjen e tyre. Në realitet, nuk është nevoja të veprohet kështu pasi dihet se ngrënia e tepërt shkakton përtaci në adhurime, ndërsa ajo që kërkohet nga muslimani në këtë muaj është ngrënia sa më pak në mënyrë që të jetë aktiv në adhurime. Disa të tjerë këtë

muaj e njohin si muajin e gjumit dhe tërë ditën flenë gjumë, saqë u kalojnë edhe namazet obligative.

Disa të tjerë këtë muaj e njohin si muaj të qëndrimit zgjuar deri në orët e hershme të mëngjesit dhe pastaj flenë duke u ikur namazi i sabahut.

Kjo është gjendja e shumë muslimanëve në kohën tonë. Ata nuk i zbatojnë obligimet dhe zhyten në mëkate duke mos e pasur frikë Allahun e Madhëruar. Çfarë vlere ka Ramazani te këta njerëz? Çfarë përfitojnë prej tij? Disa të tjerë Ramazanin e njohin vetëm si muajin e tregtisë, duke qenë të



zellshëm në shitblerje dhe si rezultat i kësaj anashkalojnë namazin me xhemat nëpër xhami. Për ta Ramazani bëhet përfitues për dynja e jo për ahiret. Disa të tjerë i shohim duke shëtitur rrugëve dhe pranë xhamive duke u shtirur si me të meta fizike apo si fukarenj të mëdhenj, në kërkim të lëmoshëve. Këta njerëz e humbin kohën e tyre në vend që ta kalojnë atë në xhami dhe në ibadet.

Të nderuar muslimanë!

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në këtë muaj ishte më i zellshëm se në çdo muaj tjetër, saqë në këtë muaj largohej nga çdo gjë tjetër duke iu përkushtuar vetëm adhurimit të Zotit. Edhe selefët e parë, kur vinte ky muaj, distancoheshin nga çdo veprim tjetër duke iu përkushtuar vetëm adhurimit dhe punëve të mira.

Ishin të zellshëm në namaz nate, e shfrytëzonin kohën në respektim të Allahut. Zuhriu, Allahu e mëshiroftë, thoshte: “Kur fillonte Ramazani, pa dyshim për ta ishte muaji i leximit të Kur’anit dhe i të ushqyerit të të varfërve. Ata ishin të kujdesshëm në shkuarjen në ligjërata në xhami dhe thoshin: “Ta ruajmë agjërimin tonë duke mos përgojuar askënd”. Ishin të kujdesshëm në namazin e teravive duke u larguar vetëm atëherë kur largohej imami. Muhamedi sal-lAl-

lahu alejhi ve sel-lem thotë: “*Kush falet në Ramazan me bindje dhe durim, Allahu do t’ia falë gjynahet e mëparshme.*”

Muttefekun alejhi

“*Kush falet me imam derisa të mbarojë ai, është sikur të falet tërë natën.*”

Kini frikë Allahun o muslimanë! Kujdesuni për muajin e Ramazanit, bëni sa më shumë vepra të mira e ndoshta do të shkruheni prej të shpëtuarve...

Muhtarat minel Hutab el Minberije të dr. Salih el Fevzanit

Përshtati: Unejs Murati



SI DUHET TA PRESIM RAMAZANIN?

Tashmë janë shumë drejtimet e njerëzve dhe pritjet e këtij muaji janë bërë të ndryshme, duke e shfrytëzuar kohën në veprat dhe aktivitetet më parësore. Disa e presin atë me përtaci, gjumë dhe pakujdesi ndaj adhurimit, disa e presin duke kaluar kohën në shikimin e televizorit dhe duke qëndruar para kanaleve të ndryshme, kurse disa të tjerë e presin atë me pagjumësi tërë natën, duke humbur kohë në vizita e shkuarje në tregje, pushimore etj. Disa e presin me teprim në ushqim dhe pirje, si të ishte muaji i ngrënies dhe i pirjes e jo i agjërimit.

Ndërsa të suksesshmit, atyre të cilëve Allahu ua do të mirën dhe ua ndriçoi rrugën e vërtetë dhe ua dalloj nga rruga e humbur, e pritën muajin e agjërimit me gëzim, hare dhe përgëzim sepse ata kuptuan se është muaji i faljes së mëkateve dhe i largimit nga rrëshqitjet, muaji i faljes, i mëshirës dhe i largimit nga zjarri i xhehenemit.

Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem i përgëzonte shokët e tij për ardhjen e muajit të agjërimit duke u thënë: "Ju erdhi juve muaji i begatshëm, obligoi Allahu për ju agjërimin e tij, hapen në të dyert e qiellit dhe mbyllen dyert e xhehenemit e prangosen gjatë tij ithtarët e shejtanëve. Në të gjendet një natë e cila e ka vlerën e një mijë netëve të tjera. Kush nuk e arrin shpërblimin e saj ka humbur shumë." Transmeton Nesaiu, saktësoi Albani.

Ata nga këto fjalë e kuptuan se çfarë mirësish, shpërblimesh dhe frytësh gjenden në këtë muaj dhe dëshiruan t'i fitojnë në mënyrë që

të mos pendohen në Ditën e Gjykimit duke thënë: "Ah, i gjori unë, sikur të isha parapërgatitur për jetën time!" Fexher, 24

Në pritjen e Ramazanit të suksesshmit përgatiten:

1. Me pendim dhe kthim tek Allahu

Pendimi nga mëkatet është obligim në çdo kohë, mirëpo në muajin e agjërimit është më obligativ. Kush nuk pendohet në muajin e agjërimit, kur do të pendohet? Kush nuk kthehet tek Allahu në këtë muaj, kur do të kthehet? Allahu thotë: "Pendohuni të gjithë tek Allahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim!" Nur: 31

Dhe thotë i madhërishti Allah: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i fal të gjitha mëkatet, Ai është që shumë fal dhe është mëshirues!"

Dhe, kthehuni te Zoti juaj dhe përlujuni Atij para se t'u vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t'ju ndihmojë. Dhe përmbajuni asaj më të mirës që u është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dënimi befas e ju të mos dini. Dhe të mos thotë ndokush: "O i mjeri unë që kam lënë mangët respektimin ndaj Allahut dhe që kam qenë prej atyre që talleshin!"

Ose të mos thotë: "Ah, sikur të më kishte udhëzuar Allahu (në rrugë të drejtë) e të kisha qenë prej atyre që janë të ruajtur!" Apo, kur ta shohë dënimin të thotë: "Sikur të isha kthyer edhe njëherë e të isha bërë prej atyre

bamirësve!" Jo, ty të patën ardhur argumentet e Mia, e ti i përgënjeshtrove ato, u bërë kryeneç dhe ishte prej atyre që nuk besuan." Zumer: 53-59

O ti që e ke vonuar pendimin, për cilën ditë e vonove pendimin dhe kthimin tek Allahu? Dikur thoshe: "Kur të agjëroj, do të pendohem. E, kur të fillojë muaji i agjëritimit, do t'i rikthehem Allahut". Ditët e këtij muaji erdhën, megjithatë ti je larg Allahut, duke ikur prej Tij e jo tek Ai, i zhytur në mëkate ndaj Tij e jo larg tyre. Si do të sigurohesh kur të vijë meleku i vdekjes, kur ti je në gjendje kundërshtimi dhe pakujdesie?

Si shpreson të të jepet rasti për pendim kur vazhdon në rrugën e kundërt me të?

Allahu i Lartësuar është falës i madh i mëkateve, e shtrin dorën e Tij natën që të pendohet mëkatari i ditës dhe e shtrin dorën e Tij ditën që të pendohet mëkatari i natës. Ai gëzohet për pendimin e të penduarve dhe kthimin e mëkatarëve. Për këtë, Allahu ka bërë "për pendimin një derë nga perëndimi, gjatësia e së cilës është 40 vjet dhe nuk e mbyll atë derisa të lindë dielli nga perëndimi", siç ka thënë Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Transmeton Ahmedi dhe Tirmidhiu.

Pendimi, vëlla i dashur, është çështje e lehtë, nuk ka vështirësi në të e as ankim gjatë kryerjes. Ai është ndalesë, pendim dhe vendosmëri: ndalesë nga mëkatet dhe kundërshtimet e urdhrave, pranim për zhytje në mëkate dhe vendosmëri në moskthim në të ardhmen.

Ku janë penduesit, të kthyerit tek Allahu i tyre?

2. Muaji i agjëritimit pritet me sinqeritet për Allahun në të gjitha punët

Vëlla i dashur, si fillim të them se nëse nuk ke sinqeritet, atëherë mos u lodh, pasi vepra pranohet vetëm me sinqeritet. Allahu thotë: "E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë, e në adhurimin

ndaj Zotit të tij të mos përziejë askënd."

Kehf: 110

Kurse Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në hadith kudsij transmeton se Allahu ka thënë: "Unë jam më i panevojshmi nga çdo lloj shoqërimi (shirkun), kështu që kush bën ndonjë vepër dhe në të më shoqëron dikë mua, e le atë dhe shirkun e tij."

3. Muaji i agjëritimit pritet me pasimin e Sunetit të Pejgamberit alejhi selam

Vepra pranohet vetëm me këto dy kushte: sinqeritet për Allahun dhe pasim i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Në ajetin e sipërpërmendur aludohet për këto dy kushte. Fjala e Allahut të Lartësuar: "E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet, le të bëjë vepër të mirë", është argument për pasimin, kurse "e në adhurimin ndaj Zotit të tij të mos përziejë askënd", Kehf: 110, është shenjë që aludon për sinqeritet.

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka sqaruar çdo gjë rreth agjëritimit, tregoi kur fillohet agjërimi dhe kur dilet prej tij, tregoi shtyllat e agjëritimit, obligimet, sunetet dhe sjelljet që kanë të bëjnë me të, tregoi mirësitë dhe frytet e tij, tregoi gjërat që e prishin atë dhe çka nuk ndikon në agjërim, tregoi raste të arsyeshme që lejojnë ngrënien gjatë këtij muaji dhe shumë gjëra të tjera që lidhen me agjërimin. Obligohemi t'i dimë dhe të punojmë sipas Sunetit të pastër të Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe të lëmë atë që e kundërshton. Kur i sqarohet një personi Suneti i Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, nuk i lejohet atij ta lërë atë për fjalën e kujt do qoftë. Secilit i merret dhe i refuzohet fjala, përveç Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem.

4. Muaji i agjëritimit pritet me durim

Muaji i agjëritimit është muaji i durimit, kur njeriu ndalet nga traditat, zakonet, ushqimet,

pirjet, epsheet e shumë veprime të tjera me qëllim respekti dhe afrimi tek Allahu i Madhërishëm.

Durimi është nga gjërat më të vështira për shpirtin, prandaj është gjysma e imanit dhe shpërblimi për të është më i madhi. Allahu në Kur'an thotë: **"Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pa masë."** Zumer: 10

Durimi është tre llojesh:

I pari: Durimi në ibadet, deri në kryerjen e tij.

I dyti: Durimi ndaj mëkatit, në moszhytje në të.

I treti: Durimi në fatkeqësi, në mosankimin te Zoti për të.

Patjetër njeriu duhet të posedojë njërin prej këtyre llojeve. Në ibadet gjenden shkaqe për durim dhe në moszhytjen në mëkate. Në mesin e tyre përmendim:

- dashurinë për Allahun,
 - frikën nga Allahu,
 - nderimin, pastrimin dhe vlerën e vetes,
 - shkurtimin e shpresës,
 - largimin nga teprimi në ushqim, pirje, veshje, marrëdhënie dhe përzjerje me njerëz,
 - turpërimin nga Allahu,
 - ruajtjen e mirësive dhe të mirave të Allahut ndaj njeriut,
 - dijen për ndyrësinë e mëkatit dhe poshtërsinë e tij,
 - dijen e plotë për përfundimin e keq që sjell mëkati, për ndyrësirën e gjurmëve të tij dhe dëmet rrjedhëse nga ai,
 - njohjen e përfundimeve të lavdëruara dhe gjurmëve të bukura që sjell agjërimi,
 - përforcimin e pemës së imanit në zemër.
- Nëse njeriu kujdeset dhe i vëren këto shkaqe, do të jenë ndihmëse për të në durim ndaj agjërimit dhe mëkatit, veçanërisht në këtë muaj, në të cilin kërkohet mund më i madh në adhurim dhe largim nga mëkatet, për arsye se mëkatarët vrapojnë në zbukurimin e

epsheve dhe të gjërave të ndaluara, që t'ua prishin njerëzve agjërimit. Pra, nevoja e muslimanit për durim në këtë muaj është tepër e madhe, Allahu na ndihmoftë!

5. Muaji i agjërimit pritet me ruajtjen e kohës dhe shfrytëzimin e saj në adhurim

Koha është e shtrenjtë dhe nga shtrenjtësia e saj është se ajo që ka kaluar nuk kthehet deri në Ditën e Gjykimit. Koha është material shpëtues ose humbës, fitues ose shkatërrues. Dijetarët e selefit të këtij umeti janë kujdesur për vitet dhe kohën e tyre, ishin të kujdesshëm për të më shumë se kujdesi i tyre për dinarin dhe dërhemin.

Umejr ibën Hanit, Allahu e mëshiroftë, i ka thënë Said ibën AbdulAzizi: "Shoh gjuhën tënde që nuk ndalet nga përmendja e Allahut. Sa herë në ditë thua subhanallah?" U përgjigj: "100 mijë, vetëm nëse gabojnë gishatat në numërim."

Said ibën el-Musejjibi thotë: "Nuk më ka ikur namazi me xhemat që prej 40 vitesh."

I ka thënë një njeri Amër ibën Abdukajsit: "Ndalu të të flas!" I ka thënë: "Ndale diellin!" Disa njerëz e kanë zgjatur qëndrimin tek el-Kerhij, derisa u ka thënë atyre: "A nuk do të ngriheni, sepse meleku i diellit nuk ndalet në lëvizjen e tij!"

6. Ramazani pritet me falje dhe edukatë të mirë

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Nëse dikush të shan apo të ngacmon (të sulmon), ti thuaj: "Unë jam agjërueshëm. Unë jam agjërueshëm." Muttefekun alejhi

Muhamedi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kush nuk e lë gënjeshtren dhe punën me të dhe injorancën, ta dijë se tek Allahu nuk ka vlerë lënia e ushqimit dhe e pijes nga ai." Sahih Ibën Maxheh 1689

Ne duhet të pajisemi me vlerat e larta të moralit islam në këtë muaj dhe në muajt e tjerë, të realizojmë atë që na kërkon Allahu i

Lartësuar, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe vëllezërit muslimanë, derisa të arrihet devotshmëria, që është edhe qëllimi kryesor i agjërimit, ashtu siç ka thënë Allahu në Kur'an: "O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç u ishte urdhëruar atyre para jush, që të jeni të devotshëm." Bekare: 183

Nga edukata e agjëruesit në këtë muaj është: - ndalja e barkut dhe e organit në realizimin e epsheve;

- mbrojtja e syrit, gjuhës, këmbës, dorës, veshit dhe të gjitha gjymtyrëve nga mëkatet; - mbrojtja e zemrës nga ambiciet e këqija, mendimet larguese nga Allahu, ndalja e saj nga të gjitha veprat e këqija.

Me këtë veprim, agjërimi prodhon një gjeneratë ndihmëse, dashuruese, bashkuese, e përgatitur për ballafaqim ndaj problemeve dhe sfidave.

8. Ramazani pritet me llogari ndaj vetes

Allahu thotë: "O besimtarë, frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!" Hashër: 18 Umeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë: "Llogaritni veten para se të llogariteni ju dhe peshojeni atë para se të peshoheni, sepse më e lehta për ju nesër është që të llogarisni veten tuaj sot!"

Llojet e llogaritjes së vetvetes

Llogaria e vetes ndahet në dy lloje: njëri lloj para veprimit dhe tjetri pas veprimit.

Lloji i parë: Llogaritja e vetes para veprimit, kur njeriu ndalet në hapin e parë të synimit dhe dëshirës së tij dhe nuk e fillon veprimin derisa t'i qartësohet veprimi mbi lënien e tij. Hasen Basriu, Allahu e mëshiroftë, thotë: "Allahu e mëshiroftë robin i cili ndalet para emocioneve; nëse ka qenë për Allahun, vazhdon, e nëse është për tjetërkënd, zmbrapset."

Lloji i dytë: Llogaritja e vetes pas veprimit, që ndahet në tre lloje:

I pari: Llogaritja e vetes për një bindje të lënë mangët në të drejtën e Allahut dhe mospërbushja e saj në formën e duhur.

E drejta e Allahut në bindje është në gjashtë çështje:

- sinqeriteti në punë,
- këshilla për hir të Allahut në të,
- pasimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në të,

- dëshmia për mirësinë e saj,
- dëshmia për mirësinë e Allahut ndaj teje,
- dëshmia për neglizhencën tënde në të.

Pra, njeriu e llogarit veten e tij nëse i ka përbushur të drejtat e këtyre gjërave dhe a ka kaluar mbi të gjitha këto pika në të gjitha veprat e tij.

I dyti: Të llogaritësh veten për çdo vepër, largimi prej së cilës është më mirë sesa veprimi i saj.

I treti: Të llogaritësh veten për punët e pëlqyera dhe të përditshme që nuk i ke vepruar. A ke pasur për qëllim Allahun dhe ahiretin e të jesh fitimtar apo ke pasur për qëllim dynjanë dhe përfitimet e saj e kështu e humb atë shpërblim?

Kështu e presim Ramazanin dhe e jetësojmë atë, gëzohemi dhe përfitojmë. E, nëse nuk e bëjmë këtë, atëherë çështja jonë mbetet ashtu siç ka thënë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: "Sa agjërues nga agjërimi i tyre nuk fitojnë gjë përveç urisë dhe etjes dhe sa falës nate (në Ramazan) nuk fitojnë gjë nga kjo përveç pagjumësisë." Transmeton Ahmedi dhe Taberani, saktësoi Albani.

E lusim Allahun t'i pranojë veprat e mira prej nesh, të mos na refuzojë si të humbur dhe të dëshpëruar!

Lutja jonë e fundit është: Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

*Përshtati:
Xheladin Leka*

O KËRKUES I SË MIRËS, NXITO...

E falënderojmë Allahun, që e dalloi muajin e Ramazanit nga muajt e tjerë, e bëri obligim agjërimin në të dhe e dalloi me disa veçori që nuk gjenden në muajt e tjerë. Besimtari i mirë dhe i sinqertë duhet të jetë i kujdesshëm gjatë këtij muaji, të punojë vepra të mira më shumë se rëndomtë dhe të jetë i devotshëm në mënyrë që të arrijë kënaqësinë e Allahut në këtë botë dhe në botën tjetër.

Muaji i Ramazanit është muaj i madh dhe i bereqetshëm, muaji i agjërimit, i leximit të Kura'nit dhe i namazit. Thamë se ky muaj ka veçori të ndryshme, në mesin e të cilave është hapja e dyerve e xhenetit dhe mbyllet dyert e xhehenemit.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Kur të vijë nata e parë e muajit të Ramazanit, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllet dyert e xhehenemit, shejtanët lidhen me pranga, dhe një thirrës thërret: “O kërkues i së mirës, nxito (kah ajo) dhe o kërkues i të ligës (mëkatit) ndalo (largohu nga ajo). Allahu për çdo natë liron njerëz nga zjarri i xhehenemit.”* [1]

Hapen dyert e xhenetit

Shtohen punët e mira, si agjërimi, namazi, lëmosha dhe pakësohen punët e liga dhe mëkatet.

Të gjitha këto janë shkaqe të cilat e shpijnë robin për në xhenet, gjerësia e të cilit është sa e gjithë toka dhe qiejt.

Mbyllet dyert e xhehenemit dhe lidhen shejtanët me pranga

Pakësohen veprat e liga, punët që janë në kundërshtim me fenë e Allahut të Lartësuar dhe lidhen shejtanët, që të mos kenë mundësi t'i pengojnë besimtarët e sinqertë në lutjet dhe adhurimet e tyre.

Një thirrës (nga qielli) thërret: “O kërkues i së mirës, nxito (kah ajo)...”

O kërkues i mirësive, nxito dhe ngutu drejt veprave të mira, të cilat i shlyejnë mëkatet dhe e pastrojnë njeriun prej tyre, si: kërkimi i faljes prej Allahut (istigfari), abdesti, falja e pesë kohëve të namazit, xhumaja deri në xhuma, Ramazani deri në Ramazan e kështu me radhë.

Nëse njeriu merr abdest ashtu siç ka marrë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe pastaj thotë: *“Dëshmoj se nuk ka kush që meriton të adhurohet përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij. O Zot, më bëj prej atyre që pendohen dhe kthehen tek Ti dhe më bëj prej atyre që janë të pastër prej gjynabeve”, do t'i hapen atij tetë dyert e xhenetit dhe hyn në xhenet nga cila derë dëshiron ai.”* [2]

Edhe pesë namazet i shlyejnë mëkatet mes tyre, përveç mëkateve të mëdha,^[3] xhumaja deri në xhuma i shlyen mëkatet përveç mëkateve të mëdha e gjithashtu edhe Ramazani

[1] Transmeton Tirmidhiu (682) dhe Ibën Maxheh (1642).

[2] Transmeton Tirmidhiu (55).

[3] Ngase për mëkatet e mëdha nevojitet pendim i sinqertë dhe largim prej tyre.

deri në Ramazan.[4]

Pra, nxitoni o besimtarë në kryerjen e atyre punëve të cilat janë shkak për shlyerjen dhe faljen e mëkateve, shpërblimi i të cilave është xheneti i Allahut, të cilin e ka përgatitur për të devotshmit.

Allahu i Lartësuar në Kur'anin Famëlartë thotë: **“Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për në një xhenet, gjerësia e të cilit është si gjerësia e qiellit dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit.”** Ali Imran: 133

Mirëpo një shpërblim i tillë, i përgatitur për të devotshmit, arrihet vetëm me punë të mira. Por kush janë të devotshmit?

Të devotshmit janë ata të cilët Allahu i Madhëruar i ka përmendur në Kur'an me fjalët: **“Të cilët japin kur janë çlirë dhe kur janë në vështirësi dhe që frenojnë mllëfin, që u falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit, edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre e kush i fal mëkatet përveç Allahut? Dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen).**

Shpërblimi i të tillëve është falja nga Zoti i tyre dhe xhenetet nëpër të cilët rrjedhin lumenj e aty do të rrinë përgjithmonë, Sa i mirë është shpërblimi i atyre që punojnë.”

Ali Imran: 134-136

O vëllezër të dashur besimtarë, ngutuni për në vepra të mira gjatë këtij muaji, të cilin Allahu e ka bërë mejdan shpëtimi për robërit e Tij, që të garojnë në të për veprat e mira. Shtojeni namazin tuaj gjatë këtij muaji, shtojeni leximin e Kur'anit, ndihmoni të varfrit dhe bonjakët, ngase kush i largon një brengë ndonjë vëllai të vet, Allahu i Lartësuar do t'i largojë atij ndonjë brengë prej brengave të tij

[4] Transmeton Buhariu (3244) dhe Muslimi (2824).

Ditën e Kiametit.

O kërkuet i të ligave, ndalo (largohu)...

Largohu prej punëve që Allahu i lartësuar i ka ndaluar dhe nuk është i kënaqur me to. Largohu prej atyre punëve që e dëmtojnë agjërimin tënd, i pakësojnë sevapet dhe i shtojnë mëkatet.

Largohu prej punëve me të cilat e hidhëron Zotin tënd, si përtacia dhe neglizhenca ndaj namazeve, mosdhënia e zekatit, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, mizoria, sjellja e keqe me prindërit, shkëputja e lidhjeve farefisnore, përgojimi, gënjeshtria, dëshmia e rrejshme, propagandimi i asaj që është në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunetin e Pejgamberit, betimi rrejshëm, rruajtja e mjekrrës, zgjatja e mustaqeve, dëgjimi i muzikës dhe gjërat e kota të cilat e dobësojnë besimin e besimtarit.

Duhet ta dini vëllezër të dashur besimtarë se mëkatet që përmendëm janë të ndaluara në çdo vend dhe në çdo kohë, mirëpo në muajin e Ramazanit gjynahu është më i madh. Frikësojuni Allahut o besimtarë, largojuni asaj që Allahu e ka ndaluar, ndihmoni njëritjetrit në të mira e në të mbara e jo në mëkate dhe armiçësi.

Përgatiti: Bali Sadiku

Referencat:

- 1 - Sahihul-Buhari
- 2 - Sahihul-Muslim
- 3 - Sunenut-Tirmidhi
- 4 - Sunen Ibën Maxhe
- 5 - El-Minhaxh, Nevevi
- 6 - Mexhmu'ul-fetava, Bin Baz
- 7 - Sherhu rijadus-salihin, El-Uthejmin
- 8 - Fet'hur-Rebbani, AbdurRahman el-Benna

NDODHITË E RËNDËSISHME NË MUAJIN E RAMAZANIT

Me të vërtetë muaji i Ramazanit për Pejgamberin sal-Allahu alejhi ve sel-lem ishte muaji i triumfeve të mëdha. Prej ndodhive që ndodhën në muajin e Ramazanit gjatë jetës së Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem do të veçojmë betejën e madhe të Bedrit dhe çlirimin e Mekës.

BETEJA E MADHE E BEDRIT RAMAZAN, VITI I DYTË

Imam Ibën Rexhebi thotë: "Beteja e Bedrit, siç dihet, ndodhi në natën e shtatëmbëdhjetë. Dita e saj ishte dita e ndarjes, dita kur u takuan dy grupet. U quajt dita e ndarjes sepse Allahu ndau mes së vërtetës dhe së kotës, e shfaqti të vërtetën dhe pasuesit e saj ndaj së kotës dhe pasuesve të saj, u ngrit fjala e Allahut dhe njësimi i Tij dhe u poshtëruan armiqtë e Allahut nga radhët e mushrikëve dhe pasuesve të librit.

Kjo betejë ndodhi në vitin e dytë të hixhretit, vit në të cilin ishte bërë obligativ agjërimi i muajit të Ramazanit, prandaj ishte Ramazani i parë që agjëroi Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem dhe muslimanët.

Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem doli në kërkim të karvanit të kurejshëve, i cili po vinte nga Shami dhe kalonte nga Medina. Këtë ditë Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem dhe shokët e tij nuk e agjëruan.

Shkaku i daljes së tij nga Medina ishte nevoja e madhe e shokëve të tij, veçanërisht e emigrantëve nga Meka. Allahu thotë: "**(Ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej**

pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë prej Allahut, dhe që ndihmojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të tillët janë ata të sinqertët." Hashr: 8

Ky karvan transportonte një pasuri të madhe për armiqtë e muslimanëve, për ata që i kishin nxjerrë nga shtëpitë dhe nga pasuria e tyre me padrejtësinë më të madhe dhe në mënyrë armiqësore, siç thotë Allahu:

"Atyre që po sulmohen me luftë, u është dhënë leje të luftojnë, për shkak se u është bërë e padrejtë, e Allahu ka fuqi për t'u ndihmuar atyre (muslimanëve). (U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: "Allahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte." Haxh: 39-40

Pejgamberi sal-Allahu alejhi ve sel-lem provoi t'ua marrë këtë pasuri zullumqarëve dhe t'ua japë shokëve të tij, të cilët ishin nxjerrë dhunshëm nga shtëpitë dhe pasuria e tyre, në mënyrë që të ishin më të fortë në adhurim ndaj Allahut dhe të kishin fuqi, që fjala e Allahut të ishte më e larta. Plaçkën e luftës Allahut e kishte lejuar për pasuesit e Muhamedit sal-Allahu alejhi ve sel-lem, por jo për popujt e mëhershëm.

Me Pejgamberin ishin 300 e disa persona, ndërsa në Sunenin e Ebu Davudit transmetohet se Abdullah ibën Amri, Allahu qoftë i kënaqur me të, thotë se ishin 315 veta. Pejgamberi u lut për ta duke thënë: "*O Allahu im! Ata janë të zbatshur, mbathi ata! Ata janë të zhveshur, vishi ata! Ata janë të uritur, ngopi ata!*" Allahu ua çeli rrugët atyre ditën e Bedrit. Atëherë u kthyen nga Bedri dhe secili prej tyre kishte nga një e më shumë deve, u

veshën dhe u ngopën. Ndërsa kur dolën ishin në kulmin e varfërisë. Ata nuk kishin dalë të përgatitur për luftë, por kishin dalë në kërkim të karvanit të kurejshëve. Me vete kishin rreth 70 deve dhe tre persona udhëtonin me një deve dhe kishin vetëm dy kuaj. Thuhet edhe tre, por thuhet se kishin vetëm një kalë, i cili ishte i Mikdadit, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Mushrikëve u shkoi lajmi për daljen e muslimanëve në kërkim të karvanit të tyre dhe Ebu Sufjani merr drejtimin e bregdetit dhe në të njëjtën kohë i lajmëron kurejshët në Mekë duke kërkuar nga ata që të dalin ta mbrojnë karvanin e tyre. Ata dolën nga Meka me britma e ulërime dhe me ta dolën edhe paria e tyre dhe marshuan drejt Bedrit. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u këshillua me muslimanët se a ishin për luftë. Iu përgjigjën muhaxhirët (mekasit), por heshti ndaj tyre sepse qëllimi i tij ishin ensarët (medinasit), sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem mendoi se ensarët ia kishin dhënë besën për ndihmë vetëm brenda Medinës e jo edhe jashtë saj. Atëherë u ngrit Sa'd ibën Ubade e tha: "Na ke ne për qëllim, domethënë medinasit? Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij, sikur të na urdhëroje të futemi në det, do të futeshim..." Ndërsa Mikdadi i tha: **"Nuk të themi siç i thanë Musait benu Israilët: "Shko pra ti dhe Zoti yt e luftoni, ne po rrimë këtu."** Maide: 24, por do të luftojmë në të majtë e në të djathtë, pas dhe prapa teje." Atëherë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u gëzua shumë dhe mori vendimin për luftë e tha: *"Ecni dhe gëzohuni, sepse Allahu më premtoi njërin prej dy grupeve dhe unë pashë të vrarët e tyre."*

Eci Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem me ushtrinë e Allahut derisa erdhën në ujin më të afërt prej ujërave të Bedrit. Habab ibën Mundhiri i tha: "O i Dërguar i Allahut! Në këtë vend që kemi zbritur, Allahu e ka cak-

tuar që ne të mos shkojmë para ose prapa apo është mendimi yt dhe strategji e jotja?" Pejgamberi iu përgjigj se ishte vetëm ideja dhe strategjia e tij e luftës. Atëherë i tha: "O i Dërguar i Allahut! Ky nuk është vend i përshtatshëm, zbresim poshtë derisa të shkojmë tek uji më i afërt i armikut, zbresim aty dhe i lëmë pas shpine burimet e pastaj ndërtojmë një pus dhe e mbushim atë me gur, pimë ne dhe nuk pinë armiqtë." Pejgamberi e miratoi këtë mendim dhe zbriti në një vend të ulët nga ana e Medinës, ndërsa kurejshët në një vend të lartë nga ana e Mekës. Allahu mes kurejshëve dhe ujit zbriti një shi të madh, që ishte dënim për kurejshët, ndërsa dhunti për besimtarët sepse e kishte bërë tokën të butë dhe të përshtatshme. Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i kishin ndërtuar një tendë, që të qëndronte në të. Ai eci në mejdanin e luftës dhe filloi të tregonte vendet se ku do të vriteshin kurejshët një nga një duke thënë: *"Ky është vendi ku do të vritet filani, ky është vendi ku do të vritet filani"*, dhe nuk e kaloi askush vendin e tij që kishte treguar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Në këtë natë, që ishte nata e xhumasë, nata e shtatëmbëdhjetë e Ramazanit, qëndroi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në këmbë tërë natën duke u lutur dhe duke qarë. Kërkonte ndihmën e Allahut ndaj armiqve të tij.

Kur u zgjuan në mëngjes, kurejshët prinë me ushtrinë e tyre e atëherë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"O Allahu im! Këta janë kurejshët, kanë ardhur me krenarinë e tyre dhe me më të famshmit prej tyre, e armiqtësojnë dhe e përgënjeshtrojnë të Dërguarin Tënd. O Allahu im, kërkoj ndihmën që ma ke premtuar! O Allahu im, zbatoje atë që më ke premtuar!"* Edhe muslimanët kërkuar ndihmën e Allahut e atëherë Allahu iu përgjigj lutjeve të tyre dhe i ndihmoi, siç thotë Allahu: **"Edhe kur Zoti yt u kumtoi engjëjve se: "Unë jam**

me ju, pra, inkurajoni ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan, e ju goditni në qafë e lart, mëshojuni atyre në çdo gjymtyrë (gishtërinj).” Enfal: 12 U takuan të dy grupet dhe lufta arriti kulmin, ndërsa i Dërguari i Allahut qëndronte te tenda e tij duke iu lutur Allahut për ndihmë. Pastaj sikur u qetësua pak e më pas doli e tha: **"Grupi do të pësojë disfatë dhe ata do të kthehen prapa."** Kamer: 45

Pastaj filloi t'i nxisë sahabët për luftë dhe mori një grusht dhe apo gurë e me të gjuajti politeistët, me të cilin i pluhurosi të gjitha fytyrat e kurejshëve. Allahu ua lehtësoi muslimanëve kraharorët e politeistëve, kështu që u imponuan ndaj tyre duke i vrarë dhe zënë robër. Muslimanët vranë shtatëdhjetë prej tyre dhe zunë robër shtatëdhjetë të tjerë. Në mesin e të vrarëve ishin: Ebu Xhehl Amr ibën Hishami, Utbe dhe Shejbe, dy djemtë e Rebias, Velid ibën Utbe dhe Umeje ibën Halefi. I Dërguari i Allahut kishte treguar vendin e vrasjes së tyre para betejës. Atëherë urdhëroi që ata të merreshin dhe të hidheshin në pusët e Bedrit, pastaj u ndal pranë tyre, i qortoi dhe ua tërhoqi vërejtjen për mohimin e tyre. Ndërsa sa u përket robërve, Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u konsultua me shokët e tij dhe pranoi mendimin e Ebu Bekrit, i cili tha: "O i Dërguari i Allahut! Ata janë kushërinjtë tanë. Mendoj të marrësh prej tyre dëmshpërblim, që të jetë për ne forcë kundër jobesimtarëve. Shpresojmë që Allahu t'i udhëzojë në Islam." Atëherë Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem mori prej tyre dëmshpërblim (fidje).

Allahu e ndihmoi të Dërguarin e Tij dhe besimtarët në Bedër duke e poshtëruar kështu politeizmin dhe pasuesit e tij. Allahu e shfaqti fuqinë e Tij duke i ndihmuar besimtarët, edhe pse ishin të dobët dhe të paktë, siç thotë Allahu: **"Allahu ju ndihmoi ju në Bedër, kur ju ishit pak në numër, e për të qenë mirënjoh-**

hës kini frikë nga Zoti." Ali Imran: 123

ÇLIRIMI I MEKËS RAMAZAN, VITI I TETË

Në këtë muaj të begatshëm rrugët e së mirës shtohen. Në Ramazan, në vitin e tetë të hixhretit, u çlirua Meka e Ndershme. Allahu e pastroi atë nga politeizmi dhe kryeneçësia. Shkaku i këtij çlirimi të madh ishte se kurejshët e prishën marrëveshjen që kishin bërë në Hudejbije, duke ndihmuar aleatët e tyre Beni Bekër ndaj aleatëve të Muhamedit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, Huza'a, duke vrarë edhe disa njerëz. Kur dëgjoi për këtë Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, tha: *"Do t'ju ndaloj nga ajo që e kam ndaluar veten."* Domethënë nuk do t'ju lë më ta prishni marrëveshjen. Pastaj kurejshët për atë që bënë u penduan, por atëherë kur pendimi nuk bënte më dobi. Ata dërguan Ebu Sufjanin në Medinë që ta ripërtërinte marrëveshjen, mirëpo nuk gjeti përgjigje nga askush.

Në anën tjetër, Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ishte bërë gati për udhëtim dhe i lajmëroi fiset arabe që kishte përreth, si: Eslem, Gafar, Xhuhejne, Eshxhe'a, Selim, etj., që të mos merrej vesh ky udhëtim. Mori rrugën me ushtrinë prej 10 mijë luftëtarësh, ndërsa në Medinë zëvendës të vetin la Abdullah ibën Umi Mektumin.

Gjatë rrugës takoi xhaxhanë e tij, Abasin me familjen e tij, të cilët ishin bërë muslimanë. Më pas takoi edhe një xhaxha tjetër, Ebu Sufjan ibën Harith ibën Abdul Mutalibin dhe djalin e hallës, Abdullah ibën Ebi Umejen. Që të dy më herët ishin armiqtë më të përbetuar të Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, por u bënë muslimanë dhe Pejgamberi e pranoi Islamin e tyre.

Kur arriti afër Mekës, në një vend që quhej "Merru Dhahran", i Dërguari i Allahut e ur-

dhëroi ushtrinë që të ndiznin 10 mijë zjarre dhe si mbikëqyrës caktoi Omer ibën Hatabin, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Në koleksionin autentik të Buhariut shkruhet kështu: "Kur udhëtoi i Dërguari i Allahut vitin e çlirimit dhe kurejshëve u arriti ky lajm, Ebu Sufjani, Hakim ibën Hizami dhe Budejl ibën Verka dolën ta vërtetonin këtë. Ecën derisa arritën tek "Merru Dhahran", ku panë shumë zjarre, si të ishin zjarret e Arafatit. Ebu Sufjani pyeti: "Ç'janë këto zjarre? Si të jenë zjarret e Arafatit." Budejl ibën Verka tha: "Janë zjarret e benu Amër." Ebu Sufjani i tha se benu Amër nuk janë kaq shumë. Duke biseduar kështu, rojet e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i panë, i morën ata dhe i sollën pranë të Dërguarit të Allahut. Atëkohë Ebu Sufjani u bë musliman. Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem atë ditë e urdhëroi Halid ibën Velidin që të hynte nga pjesa e poshtme e Mekës nga Keda, ndërsa Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem hyri nga pjesa e epërme, e quajtur Kuda. Ushtria e Halid ibën Velidit vrau gjatë marshimit të saj Hubejsh ibën Esh'arin dhe Kerez ibën Xhabir El Fihrijin.

Abdullah ibën Mugafel thotë: "E kam parë të Dërguarin e Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ditën e çlirimit të Mekës përmbi denë e tij duke lexuar suren Fet'h." Ndërsa Abdullah ibën Mes'udi thotë: "I Dërguari i Allahut hyri në Mekë ditën e çlirimit dhe përreth Qabes ishin vendosur 360 idhuj. Atëherë filloi t'i rrëzojë me shkopin e tij dhe lexonte fjalët e Allahut: **"Dhe thuaj: "Erdhi e vërteta e u zhdruk e kota". Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdrukur"** Isra: 81, dhe **"Thuaj: "Erdhi e vërteta, e kota u zhdruk pa fillim dhe pa kthim!"** Sebe'e: 49

Nga Abdullah ibën Abasi transmetohet se i Dërguari i Allahut, kur hyri në Mekë, nuk pranoi të hyjë në Qaben e mbushur me idhuj, por urdhëroi që të nxirren jashtë.

Në mesin e idhujve nxorën edhe pikturën e Ibrahimit dhe të Ismailit që ishin duke shikuar shigjetëzat për lojë. Atëherë Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"Allahu i vraftë, e kanë ditur se ata kurrë nuk kanë besuar në to!"* Pastaj hyri në Qabe, e madhëroi Allahun në të gjitha anët e saj, dhe i fali dy rekate në të." Pastaj Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem i siguroi banorët e Mekës duke thirrur një thirrës me urdhrin e të Dërguarit: "Ai që hyn në xhami është i sigurt, ai që hyn në shtëpinë e Ebu Sufjanit është i sigurt dhe ai që hyn në shtëpinë e vet është i sigurt." Nga kjo përjashtoi disa persona, të cilët i Dërguari urdhëroi të vriteshin për shkak të këqijave të tyre të shumta. Pastaj Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem u ul në xhami, kurse njerëzit e shikonin frikshëm duke menduar se ç'do të bënte me mushrikët, me armiqtë e tij, të cilët e kishin torturuar dhe e kishin nxjerrë nga vendlindja e tij, e kishin luftuar dhe shpeshherë kishin tentuar ta vrisnin. Pastaj Pejgamberi u tha: *"O popull kurejsh! Si mendoni, ç'keni merituar dhe çfarë do të bëj tani me ju?"* U përgjigjën: *"Vetëm të mira, sepse ti je vëllai dhe biri fisnik i vëllait fisnik."* I Dërguari i Allahut tha: *"Do t'ju them njësoj siç u ka thënë Jusufi alejhi selam vëllezërve të vet: "Unë tani nuk do t'ju qortoj, shkoni, ju jeni të lirë."* E më pas filluan t'i jepnin besën për Islam. Me këtë çlirim të qartë u plotësua ndihma e Allahut. Njerëzit filluan të hyjnë në Islam grupe-grupe. Vendi i Allahut u kthye në vend islam, u ngrit në të njësimi i Allahut, vërtetimi i të Dërguarit të Tij dhe zbatimi i ligjit të Tij dhe shteti u bë i muslimanëve, u shkatërrua politeizmi dhe u çrrënjos errësira e tij. Allahut i qoftë falënderimi. Kjo është nga mirësitë e Allahut ndaj robërve të Vet deri në Ditën e Gjykimit.

*"Lufta e të Dërguarit në Ramazan"
Shtëpia botuese "Darul Vatan"
Përshtati: Fidan Xhelili*

HADITHE TË PASAKTA, TË PËRHAPURA TEK NJERËZIT RRETH MUAJIT TË RAMAZANIT

Falënderimi i takon vetëm Allahut që pejgamberin tonë e ka dërguar si sqarues të dispozitave të fesë, dhe këtë me hadithet e tija që janë transmetuar nga shokët e tij besnik. Mirëpo, pas kohës së pejgamberit tonë njerëzit gjatë historisë kanë shpikur fjalë të ndryshme dhe ato ia kanë mveshur pejgamberit tonë, dhe prej lëmive që kanë shpikur në to janë edhe ato në çështjet e Ramazanit. Më poshtë po paraqesim disa hadithe të dobëta, të cilat shpeshherë njerëzit i marrin për thënie të Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sellem, kurse ato në realitet nuk janë fjalë të tij dhe nuk janë transmetuar nga ai. Ebu Hurejra radijallahu anhu transmeton se Muhamedi sal-lallahu alejhi ve sellem ka thënë: *"Kush thotë diçka për mua, që nuk e kam thënë unë, le të përgatisë karrikën e tij prej zjarrit."* Buhariu, Muslimi, dhe shumë të tjerë. Ndër këto hadithe përmendim:

1 - Hadithi: *"Ky (Ramazani) është një muaj, fillimi i të cilit është mëshirë, mesi i tij është falje, fundi i tij është largim nga*

zjarri."

Hadithi është i pasaktë, e transmeton Ibën Huzejme në Sahihun e tij (1887) dhe thotë: "Nëse hadithi është i saktë"! Ky hadith është nga Ali ibën Zejdi, për të cilin ibën Huzejme thotë: "Nuk argumentoj me të, sepse ka qenë i dobët në memorie, në të mësuarit përmendësh."

Ibën Haxheri në "El-Etraf" thotë: "Ali ibën Zejdi është i dobët."

Silsiletud-Daife 2/262 të Albanit.

*"Kush thotë
diçka për mua, që
nuk e kam thënë unë,
le të përgatisë karrikën
e tij prej zjarrit."*

Hadith Mutevatir

2 - Hadithi: *"Agjëroni, do të jeni të shëndetshëm."*

Hadithi është i dobët, e transmeton Taberani në Evsat 2/225/1/8477.

Hadithin gjithashtu e ka vlerësuar si të dobët edhe

Hafidh El-iraki në nxjerrjen që i ka bërë në "El-Ihja" 3/75, dhe dietari Albani në Silsiletud-Daife 1/420.

3 - Hadithi: *"Kush nuk agjëron një ditë të muajit Ramazan pa ndonjë arsye apo sëmundje, nuk mund të bëjë kompensimin e saj edhe nëse agjëron tërë jetën."*

Hadithi është i dobët, "Daif Suneni Ebi Davud" 2/314 të Albanit.

4 - Hadithi: "Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur bënte iftar thoshte: "O Zot, për ty kam agjëruar, me të mirat e tua bëj iftar, prano nga ne, me të vërtetë ti je i Ditur dhe Dëgjues!" Apo edhe vetëm: "O Zot, për ty kam agjëruar, me të mirat e tua bëj iftar."

Hadithi është i dobët, Ibën Kajjimi në Za'dul Mead tregon se ky hadith nuk ekziston fare, Kelimetu et-Tajjib fq. 140, Irvaul Galil (4).

Mirëpo duaja e vërtetë, që është transmetuar nga Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në rastin e iftarit, është: "Dhehebe edh-Dhameu ve ibteletil uruku ve thebetel exhru inshallahu", që do të thotë: "Kaloi etja, u lagën damarët, dhe u arrit shpërblimi inshallah". Hadithi është Hasen, tra.Ebu Davudi në Sunenin e tij (2/306), me recensim të Albanit.

5 - Hadithi: "Pesë gjëra e prishin agjërimin dhe abdestin; gënjeshtria, përgojimi, mbartja e fjalëve, shikimi me epsh dhe betimi rrejtshëm."

Hadithi është i rrejshëm, e transmeton Ibën Xhevzi në librin e tij "el-Mevduat" dhe thotë se është i rrejshëm. Gjithashtu para tij ka thënë edhe Ebu Hatimi se ky hadith është i shpikur. Shiko Silsiletud-Daife 4/199, të Albanit.

6 - Hadithi: "Agjëruesi i Ramazanit në udhëtim është sikur mosagjëruesi në vendlindje."

Hadithi është daif. Silsiletud - Daife 1/713, të Albanit.

7 - Hadithi: "Agjëruesi është në adhurim

derisa të mos përgojojë."

Hadith është daif. Silsiletud - Daife 4/311, të Albanit.

8 - Hadithi: "Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është pyetur për agjërimin e udhëtarit dhe ka thënë: "Kush nuk agjëron (në udhëtim), kjo është lehtësim, e kush agjëron, agjërimi është më i mirë." Hadith është daif, shiko Silsiletud-Daife 2/336, të Albani.

9 - Hadithi: "Kur të jetë nata e parë e muajit Ramazan, Allahu shikon në krijesat e Tij, e nëse Allahu shikon në krijesat e Tij, nuk i dënon ata asnjëherë dhe Allahu për çdo natë largon nga zjarri një mijë nga robërit e Tij."

Hadithi është i shpikur, shiko Silsiletud-Daife 1/470, të Albanit.

10 - Hadithi: "Sikur ta dinin robërit çfarë (shpërblimesh) ka në Ramazan, do të dëshironin të jetë tërë viti Ramazan."

Hadithi është i shpikur, shiko "Daifut-Tergib vet-Terhib" nga Albani, vëllimi i 1.

11 - Hadithi i Jezid ibën Rumanit: "Gjatë kohës kur ishte udhëheqës i muslimanëve Umer bin Hatabi, njerëzit në muajin e Ramazanit kanë falur njëzet e tri rekate."

Hadithi është i dobët, transmeton Malik 1/138, Bejhakui në Sunenin e tij 2/496. Arsyeja pse hadithi është i dobët është se transmetuesi Jezid ibën Rumanit nuk e ka arritur fare kohën e udhëheqësisë së Umerit.

12 - Hadithi i Saib ibën Jezidit: *"Gjatë kohës kur ishte udhëheqës i muslimanëve Umer bin Hatabi, njerëzit në muajin e Ramazanit kanë falur njëzet rekate..."*.

Hadithi është i dobët, e transmeton Bejhakui në Sunenin e tij 2/496 nga rrugët e transmetimit të Jezid ibën Husejfete nga Es-Saibi. Ibën Jezidi, kur është pyetur për numrin e rekateve, ka thënë: "Kam menduar se Saibi ka thënë: "Njëzetë e një". Thënia e tij "njëzetë e një" rekate është në kundërshtim me thënien e tij të mëherëshme "njëzetë rekate". Gjithashtu shprehja "kam menduar" është argument i turbullimit të Ibën Husejftes në transmetimin e numrit të rekateve, shiko "Namazi i teravive nga Albani", fq. 48-52.

E vërteta nga Umer ibën Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, është se ka urdhëruar për faljen e njëmbëdhjetë rekateve në hadithin e Saib ibën Jezidit, i cili ka thënë: "Omer ibën Hatabi ka urdhëruar Ubej ibën Ke'abin dhe Temim ed-Darin që t'ua falin njerëzve nga njëmbëdhjetë rekate." Ka thënë "Kanë lexuar mirë dhe qetë, derisa jemi mbajtur në shkopinj nga zgjatja dhe nuk jemi shpërndarë deri në agim të mëngjesit." Hadithi është i vërtetë, e transmeton Imam Maliku në el Muvatta 1/137, nr. 248.

*Përmbledhur nga recensimet e muhadithit Muhammed Nasiruddin Albani
Përshtati: Unejs Murati*



UDHËZIMI I MUHAMEDIT NË NAMAZIN E TARAVIVE

Imam Maliku ka transmetuar në “El Muveta” nga Es-Saib ibën Jezidi se ka thënë: “Umer Ibën Hatabi ka urdhëruar Ubej ibën Ke’abin dhe Temim ed-Darin që t’u falin njerëzve 11 rekate.” Dhe ka thënë: *“Kanë lexuar mirë dhe qetë, derisa jemi mbajtur në shkopinj nga zgjatja dhe nuk jemi shpërndarë deri në agim të mëngjesit.”* Hadithi është i vërtetë, transmeton imam Maliku në el Muveta 1/137, nr. 248.

Ky ka qenë një ushtrim luftarak për muslimanët uri dhe etje gjatë ditës, qëndrim zgjuar me orë të tëra gjatë natës dhe ka lënë gjurmë të mëdha në përgatitjen e gjeneratave të forta të muslimanëve, të cilët arritën të çlironin shumë vende duke mposhtur dy perandoritë më të mëdha, Romën dhe Persinë. Ushitari musliman u bë kështu nga më të çuditshmit, saqë edhe gjenerali gjerman Bismark tha: “Më jepni 10 000 ushtarë muslimanë, e çliroj me ta tërë botën.”

Shumë muslimanë e kanë humbur fatkeqësisht këtë urtësi të namazit të taravive, duke e falur atë shpejt. Fatkeqësisht, kush e fal shpejt namazin e taravive shpallet imami më i mirë. Përse? Sepse e ka falur namazin e taravive për 19 minuta! Këtë traditë të xhemati e kanë mbjellë vetë hoxhallarët, të cilët në atë mënyrë nuk bëjnë mirë as qëndrimin në këmbë, as rukunë dhe as sexhden.

Jam i bindur se shumica e namazeve të tilla nuk janë të pranuar, nëse kemi parasysh hadithin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sellem, i cili i ka thënë atij njeriut që e ka

shpejtuar namazin duke mos u qetësuar në namaz: *“Falur, se ti nuk je falur.”* (Sahih Suneni Ebi Davud 1/226 me vërtetim nga Albani.)

Numri i rekateve të taravive

Nuk i ka falur Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sellem taravitë me më shumë se 11 rekate bashkë me vitrin. Ebu Selemetu ibën Abdurrahman ka pyetur Aishen, Allahu qoftë i kënaqur me të:

“Si ka qenë namazi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sellem në Ramazan?” Ajo ka thënë: *“Nuk ka shtuar Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sellem në Ramazan e as jashtë Ramazanit më shumë se 11 rekate. Ka falur katër rekate, mos pyet për mirësinë dhe zgjatjen e tyre. Pastaj ka falur katër të tjera, mos pyet për mirësinë dhe zgjatjen e tyre. Pastaj ka falur tre rekate të vitrit.”* (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Dobësimi i hadithit të 20 rekateve

Hadithi i 20 rekateve është shumë i dobët dhe nuk lejohet të punohet me të. Është përmendur në “Fet’h” se ajo që është transmetuar nga Ebi Shejbetë për hadithin e Ibën Abasit, se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sellem ka falur 20 rekate në Ramazan dhe vitrin, e ka zinxhirin shumë të dobët, bile e kundërshton hadithin e Aishes, i cili është autentik pa asnjë dyshim, duke e ditur se Aishja ka pasur më shumë njohuri për gjend-

jen e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gjatë natës.

Gjithashtu hadithin e 20 rekateve e ka cilësuar të dobët edhe dijetari hanefi ez-Zejleai në “Nasbu err-Rrajeti”. Es- Sujuti thotë: “Ky hadith është shumë i dobët.” (El Havi lil Fetava)

Gjithashtu, fekihi el Hejthemi në librin e tij “El Fetava el Kubra” ka thënë: “Dobësimi i tij është se Shejbetu ibën Ibrahim ibën Uthmani është i anashkaluar, siç ka thënë ibën Haxheri në “Et Takrib”.”

Pasimi i Sunetit të Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem

Falja nga ana e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e 11 rekateve gjatë tërë jetës së tij, duke mos shtuar më shumë në Ramazan apo jashtë Ramazanit, është argument se ndalohet shtojca.

Nëse meditojmë pak për namazet vullnetare, si sunetet apo edhe namazet e tjera, si namazi i kërkimit të shiut apo namazi i eklipsit të Hënës apo Diellit, ku Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka falur numër të caktuar rekatesh, ky është argument shumë i qartë për dijetarët se nuk lejohet të shtohet diçka në to. Edhe në namazin e taravive nuk lejohet të shtohet diçka në numër përveç asaj që ka bërë Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ashtu siç nuk lejohet shtimi në namazet që përmendëm më lart. E nëse dikush bën dallim mes këtyre namazeve edhe namazit të taravive në dispozitë, le të sjellë argument.

Namazi i taravive nuk është i hapur, që muslimani të zgjedhë dhe të falë rekate sa të dojë, edhe pse është sunet i fortë që u ngjan namazeve obligative, ngase falet me xhemat.

Ringjallja e namazit të taravive me xhemat me 11 rekate nga ana e Umerit

Pas vdekjes së Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem njerëzit kanë vazhduar ta falin na-

mazin e taravive në xhami të shpërndarë, me numër të ndryshëm imamësh. Kjo gjendje ka vazhduar në kohën kur ishte udhëheqës i muslimanëve Ebu Bekri dhe në fillim të pushtetit të Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të dy. Pastaj Umeri e bashkoi xhematin me një imam të përbashkët dhe në këtë rast ka thënë: “*Sa bidat i mirë është ky.*”

Rasti i Umerit ka ngjallur disa dyshime te disa persona, të cilët e merrnin si pretekst për të legjitimuar risitë në fe, edhe pse çdo risi në fe është e kotë. Po përmendim dy nga dyshimet e tyre duke i shëruar ato me argumente të qarta.

E para: Ata thonë se bashkimi për namazin e taravive është bidat sepse nuk ka qenë në kohën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem!

Përgjigjja: Ky është gabim fatal, ashtu siç e qartësuam më lart.

E dyta: Ata thonë: se në bidat ka gjëra të mira dhe të lavdëruara, duke përfshirë diçka nga thënia e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: “*Thënia më e vërtetë është thënia e Allahut, kurse udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Veprat më të këqija janë ato të shpikurat, çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje, e çdo lajthitje çon në zjarr.*” Dhe shumë hadithe të tjera me këtë kuptim.

Përgjigjja: Edhe kjo gjithashtu është e kotë, se fjala e Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të: “*Sa i mirë është ky bidat*”, nuk ka për qëllim bidatin legjitim në Islam, që është shpikja e diçkaje të re në fe, e cila nuk ka shembull të mëhershëm. Ajo që mësuam më lart ishte se ai, Allahu e mëshiroftë, nuk ka shpikur diçka të re, por ka ringjallur më shumë se një sunet pejgamberik. Ai ka pasur për qëllim bidatin në kuptimin gjuhësor, që ka kuptimin diçka e re, që nuk ka qenë e njohur më herët para se të ndodhte. Pa dyshim që namazi i taravive me xhemat me një imam nuk

ka qenë i njohur në kohën e Ebu Bekrit, ashtu siç e treguam më lart, dhe në këtë kup-tim është diçka e re, mirëpo, në anën tjetër, kjo është në pëlqim me veprën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe është sunet e jo bidat.

Thënia e Umerit, Allahu qoftë i kënaqur me të, për namazin e taravive: “Sa i mirë është ky bidat”, ka pasur për qëllim anën gjuhësore dhe për këtë kemi edhe shembuj të tjerë, siç është edhe fjala e Allahut në Kur’an: **“Thuaj: “Unë nuk jam risimtar prej të Dërguarve...”** Ahkaf: 9

Pra, nuk kemi të bëjmë me bidat në fenë islame, se bidati në fe është humbje, ashtu siç na ka treguar Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Thamë më lart se Umeri ka urdhëruar faljen e 11 rekateve dhe zinxhiri i transmetimit është i vërtetë.

Nuk ka transmetime të sakta se Umeri ka falur 20 rekate

Ka disa transmetime sipas të cilave thuhet se njerëzit në kohën e Umerit në muajin Ramazan kanë falur nga 23 rekate, mirëpo nuk ka diçka të vërtetë në të, pasi në transmetim është Husejfete dhe nga ai hadithet janë të urryera, siç ka thënë imam Ahmedi, pasi ai ka kundërshtuar atë që është më i besueshëm se vetë ai; ka kundërshtuar Muhamed ibën Jusufin, i cili ka përmendur se numri i rekateve është 11. Gjithashtu ka ndërprerje mes Jezid ibën Rumanit dhe Umerit dhe e ka bërë të dobët hadithin e parë, i cili aludon për 23 rekate. Bejhakui dhe pastaj Neveviu e kanë konsideruar të dobët, madje edhe imam Shafiu, siç është përmendur në “Muhtesar el Muzeni” dhe Tirmidhiu në “Sunenin” e tij. Suneti i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e meriton më shumë që të pasohet Ta zëmë se disa nuk pajtohen me dobësimin e asaj se Umeri ka falur 20 rekate, edhe pse është shumë larg logjikës, apo le ta zëmë se

dikush na argumenton me diçka të vërtetë se Umeri i ka falur taravitë me atë numër rekatesh, diçka që është edhe më larg logjikës, por këtyre njerëzve u themi: Nuk jemi të obliguar të pasojmë këtë numër e të lëmë anash veprën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem me 11 rekate, edhe pse fatkeqësisht praktikuesi i këtij suneti llogaritet si i larguar nga xhemati.

*Agjërimi i Ramazanit,
autori: Mahmud Fehdi el Istambuli
Përshtati: Unejs Murati*



FETVA TË RËNDËSISHME PËR AGJËRUESIN



Dalja e gjakut (analizat e gjakut)

Dalja e gjakut nga cilado pjesë e trupit nuk e prish agjërimin, qoftë edhe nga hunda apo goja, mirëpo duhet të kemi kujdes: nëse gjaku del nga hunda apo goja, mos ta gëlltisim. As analizat e gjakut nuk e prishin agjërimin, pa marrë parasysh sa është sasia e gjakut të nxjerrë nga trupi.

Përdorimi i pastës së dhëmbëve

Përdorimi i pastës së dhëmbëve për agjëruenin ndahet në dy lloje.

Lloji i parë: Nëse pasta ngjitet në gojë dhe ka mundësi të depërtojë në brendësinë e trupit të agjëruetit, atëherë kjo lloj paste nuk lejohehet të përdoret, ngase ndalohehet përdorimi i çdo gjëje që depërton në brendësi të trupit të agjëruetit.

Lloji i dytë: Nëse pasta është normale dhe largohet me ujë dhe nuk ka mundësi të depërtojë në brendësinë e trupit të agjëruetit, lejohehet të përdoret ashtu siç lejohet futja e ujit në gojë gjatë abdestit apo jashtë tij.

Vendimi i përdorimit të injeksioneve ushqyese, insulinës, vaksinimit dhe anestezisë

Injeksionet që përdor i sëmurit ndahen në përgjithësi në dy grupe:

Grupi i parë: Injeksionet shëruese, të cilat përbajnë vetëm ilaçe dhe shërim, por jo ushqim, pa marrë parasysh a përdoren nën

lëkurë, në muskuj apo në damarë. Përdorimi i këtyre injeksioneve lejohehet dhe këtu futen vaksinimi, anestezia lokale, insulina. Të gjitha këto nuk e prishin agjërimin sepse nuk kanë lidhje me stomakun, barkun apo me aparatën e ushqimit të njeriut.

Grupi i dytë: Injeksionet që përbajnë lëndë ushqyese, të cilat jepen kur njeriu është i sëmurë, i plogësht apo pas ndonjë operimi, si për shembull: glukozja dhe serumi. Këto futen në trup dhe kryejnë funksionin e të ushqyerit (ngrënies dhe pirjes), saqë njeriu rri me ditë e net pa ngrënë asgjë duke u mbështetur vetëm në këto injeksione ushqyese, prandaj konsiderohen prej gjërave prishëse të agjërimit dhe përdoruesi i tyre duhet të kompensojë.

Pastrimi nga xhunubllëku pas agimit dhe ejakulimi në gjumë gjatë ditës së Ramazanit

Nuk ndikon asgjë negativisht në agjërimin e muslimanit nëse ai e ka filluar agjërimin duke qenë i papastër nga xhunubllëku, ngase edhe Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-em e ka zënë agimi duke qenë xhunub.

As ejakulimi në gjumë gjatë ditës nuk e prish agjërimin, ngase ndodh pa vetëdijen e njeriut dhe Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive.

Pamundësia e të agjëruarit nga i moshuari dhe i sëmurit me sëmundje kronike

Nëse personi i moshuar nuk ka mundësi të

agjërojë për shkak të moshës, për të nuk është e lejuar ta mundojë veten me agjërim ngase Allahu i Lartësuar thotë: **"Mos e mbytni veten tuaj, Allahu është i mëshirshëm ndaj jush."** Nisa: 29

Në vend të agjërimit, ky person duhet të ushqejë për çdo ditë një të varfër ose i lejohet të përgatisë një gosti dhe të ftojë aq të varfër sa janë ditët e Ramazanit. E njëjta gjë vlen edhe për personin i cili është i sëmurë me sëmundje nga e cila nuk ka shërim; pra, ushqen aq të varfër sa janë ditët e Ramazanit, për çdo ditë nga një të varfër, ashtu siç e përmendëm më lart.

Loja dhe puthja me gruan gjatë agjërimit

Lejohet që agjëruesi ta puthë gruan e tij dhe të luajë me të, edhe pse është agjërueshëm, nëse është i moshuar, kurse për të riun një gjë e tillë nuk është e preferuar. Argument për këtë është rasti kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ia kishte lejuar këtë një plaku, por nuk ia kishte lejuar një të riu.

Përdorimi i supozitorëve për të sëmurin gjatë ditës së Ramazanit

Lejohet përdorimi i supozitorëve sepse nuk janë ushqim e as pirje dhe nuk zëvendësojnë ushqimin dhe pirjen, prandaj edhe nuk hyjnë në ndalesë.

Prishja e agjërimit për shkak të provimeve dhe agjërimi i shoferit në rrugë të gjata

Nuk lejohet prishja e agjërimit për shkak të provimeve ngase agjërimi nuk është pengesë për të mësuar. Edhe nëse agjërimi e pengon njeriun nga mësimi, ai ka mundësi të mësojë pas iftarit, kështu që ky person s'ka asnjë arsye që të prishë agjërimin.

Sa i përket shoferit në rrugë të gjata, atij i le-

johet të mos agjërojë derisa të lirohet nga kjo punë. E, kur është pushim apo është dimër dhe ka mundësi të agjërojë, obligohet t'i kompensojë ato ditë të Ramazanit që nuk i ka agjëruar, ngase Allahu i Lartësuar thotë: **"Sa i përket atij që është i sëmurë, ose gjendet në udhëtim e sipër, le të agjërojë më vonë aq ditë sa nuk i ka agjëruar."** Bekare: 185

Përdorimi i barnave për ndalimin e menstruacioneve gjatë Ramazanit

Gruas i lejohet përdorimi i barnave për ndalimin e menstruacioneve në Ramazan, nëse ekspertët mjekësorë konstatojnë se kjo nuk i bën dëm shëndetit të saj dhe nuk e dëmton mitrën e saj, edhe pse largimi nga ky veprim është më i mirë. Allahu i Lartësuar mosagjërimin në kohën e ciklit e ka bërë lehtësim për të, ndërsa këtë ia ka zëvendësuar duke i caktuar kompensim për ditët e ciklit. Kjo është pjesë e fesë për të.

*Përgatitën:
Zejd Haziri
Xheladin Leka*

Referencat:

- 1 - Mexhmu'ul-Fetava të Bin Bazit
- 2 - Mesail anis-Sijam, El-Uthejmin
- 3 - Tebsiretul-Enam bi ehemmi mesailis-Sijam, Abdullah el-Hamadi
- 4 - Sifatu Savmin-Nebijj, Ali el-Halebi & Selim Hilali
- 5 - Fikhu en Nevazil, El Xhizani



DISPOZITAT E AGJËRIMIT

Dije, o ti musliman, se këtë shpërblim madhështor dhe mirësi të çmuar, të cilën nuk mund ta llogarisë vetëm se falësi më i madh, Mëshirëploti, e fiton vetëm ai që e agjëron Ramazanin sipas shembullit të Vulës së Pejgamberëve sal-Allahuhu alejhi ve sel-lem dhe në përputhje me dispozitat që kanë të bëjnë me këtë obligim madhështor dhe me këtë muaj të begatë.

Po fillojmë të paraqesim sqarimin e tyre pa imitim të verbër, duke marrë nga Kur'ani dhe Suneti i pastër, sipas kuptimit të të parëve tanë të mirë, prej katër imamëve dhe atyre që kanë qenë para tyre nga sahabët dhe tabi'inët. Dhe ky argumentim është i mjaftueshëm.

1. PARA FILLIMIT TË RAMAZANIT

1. Numërimi i ditëve të muajit Shaban

Umeti musliman duhet t'i numërojë ditët e muajit Shaban në mënyrë që të përgatitet për Ramazanin, pasi muaji mund të jetë me 29 apo me 30 ditë, ndërsa agjërimi duhet të fillohet me dallimin e Hënës së re. Por nëse qielli është me re, atëherë llogaritja bëhet duke plotësuar tridhjetë ditë nga Shabani. Kjo sepse Allahu, Shpikësi i qiejve dhe i Tokës, e ka bërë kohën e daljes së Hënës shenjë për llogaritjen e kohës dhe viteve dhe dihet se muaji hënor nuk i kalon tridhjetë ditët.

Transmetohet nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se i Dërguari i Allahut sal-

lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Filloni agjërimin me dallimin e Hënës dhe përfundojeni atë me dallimin e saj; e nëse keni pengesë nga retë, atëherë plotësojeni Shabanin tridhjetë ditë."*^[1]

Transmetohet nga Abdullah ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se i Dërguari i Allahut sal-Allahuhu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mos agjëroni derisa ta shihni Hënën dhe mos e çelni agjërimin derisa ta shihni atë. Por nëse ju pengojnë retë (nga shikimi i Hënës), atëherë llogariteni me ditë."*^[2]

2. *Kush agjëron ditën e dyshimtë,^[3] ka kundërshtuar Muhamedin sal-Allahuhu alejhi ve sel-lem* Nuk i lejohet muslimanit që ta paraprijë Ramazanin me agjërimin e një apo dy ditëve për siguri (se ndoshta mund të ketë hyrë muaji i Ramazanit), me përjashtim të atij që e ka zakon të agjërojë disa ditë në javë dhe njëra prej atyre ditëve qëllon para muajit të Ramazanit.

Transmetohet nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se i Dërguari i Allahut sal-Allahuhu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Mos e pritni Ramazanin me agjërimin e një apo dy ditëve, përveç atij që e ka pasur zakon ndonjë agjërim, ky le të agjërojë."*^[4]

3. *Nëse dëshmon një dëshmitar për daljen e Hënës, atëherë agjëroni apo prisheni agjërimin* Dalja e Hënës vërtetohet me dëshminë e dy

[1] Transmeton Buhariu (4/106), Muslimi (1081).

[2] Transmeton Buhariu (4/106), Muslimi (1080).

[3] Është për qëllim ajo ditë që mendohet të jetë dita e parë ose e fundit e Ramazanit (sh.p).

[4] Transmeton Muslimi (573- versioni i shkurtuar i tij).

personave muslimanë, të drejtë, se e kanë parë atë, bazuar në fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Agjëroni kur ta shihni atë (hënën) dhe prisheni agjërimin përsëri kur ta shihni atë (të dalë për muajin sheval -pas Ramazanit). Ruajeni atë, e nëse ju pengojnë retë, atëherë plotësoni tridhjetë ditë. Nëse dëshmojnë dy dëshmitarë (për daljen e saj), atëherë agjëroni apo prisheni agjërimin."*^[5]

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se pranimi i dëshmisë nga dy persona në gjendjen aktuale e përjashton pranimin e dëshmisë së një dëshmitari të vetëm. Për këtë lejohet dëshmia e një dëshmitari të vetëm në shikimin e hënës. Është vërtetuar nga Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: *"Njerëzit po ruanin daljen e hënës, ndërsa unë e njoftova të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem sepse e pashë atë. Atëherë ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem agjëroi dhe urdhëroi njerëzit të agjërojnë."*^[6]

2. NIJETI

1. Obligimi i bërjes së nijetit për agjërimin e obliguar që para hyrjes së sabahut

Nëse është vërtetuar hyrja e Ramazanit me shikim të syrit apo nga ana e dëshmitarëve ose me plotësimin e muajit Shaban, obligohet çdo musliman i ngarkuar nga sheriatu që të vendosë, të bëjë nijet për agjërimin që në mbrëmje, sepse i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kushdo që nuk e bën nijetin për agjërim para agimit, ai nuk ka agjërim (nuk i qubet agjërimi)."*^[7]

Vendi i nijetit është zemra, ndërsa shprehja e tij me gjuhë është bidat, risi e humbur, edhe nëse njerëzit e shohin si të mirë. Sa i përket bërjes së nijetit para agimit, kjo është

e posaçme për agjërimin që është obligim, pasi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem shkante tek Aishja në muajt e tjerë jashtë Ramazanit dhe i thoshte: *"A ka diçka për drekë? Nëse jo, unë po agjëroj."*^[8] Diçka e tillë është përcjellë gjithashtu edhe nga sahabët, si Ebu Derda, Ebu Talha, Ebu Hurejra, Ibën Abasi dhe Hudhejfe ibnul-Jemani, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Kjo ka qenë për agjërimin vullnetar, kështu që argumenton qartë se bërja e nijetit që me natë është obligim vetëm për agjërimin e detyrueshëm. Allahu e di më së miri!

2. Mundësia është kusht i obligueshmërisë së agjërimit

Ai që e arrin Ramazanin dhe nuk është informuar për të, por ka ngrënë dhe ka pirë gjatë ditës, pastaj është lajmëruar, duhet të ndalet nga ushqimi dhe ta plotësojë agjërimin, i cili i konsiderohet i saktë (edhe pse ka ngrënë në fillim të ditës). Ndërsa ai që nuk ka ngrënë ende, pastaj mëson se ka hyrë Ramazani, të mos hajë, por të agjërojë. Për sa i përket bërjes së nijetit që me natë, ai nuk qëndron më si kusht për këtë sepse ai nuk ka pasur mundësi për të (pasi nuk e dinte se të nesërmen do të ishte Ramazan). Siç dihet, nga bazat e këtij sheriatu të drejtë është se obligueshmëria dhe ngarkimi me të është në varësi të mundësisë.

Aishja, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, transmeton se *"i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kishte urdhëruar që të agjërohet dita e Ashures. E, kur u bë obligim agjërimi i muajit Ramazan, kush donte agjëronte dhe kush donte nuk agjëronte."*^[9]

Ndërsa nga Seleme ibën Ekva transmetohet

[5] Transmeton Nesai (4/132), Ahmedi (4/321) dhe Darekutni (2/167). Senedi i këtij hadithi është hasen- i mirë.

[6] Transmeton Ebu Davudi (2342), Darimiu (2/4), Ibën Hibbani (871), Hakimi (1/423) dhe Bejhakiu (4/212); nga dy rrugë të ndryshme. Senedi i këtij hadithi është sahih – i saktë, siç ka thënë Ibën Haxheri në "et Telhis el Habir" (2/187).

[7] Transmeton Ebu Davudi (2454), Ibën Huzejme (1933), Bejhakiu (4/202).

[8] Transmeton Muslimi (1154).

[9] Transmeton Buhariu (4/212) dhe Muslimi (1125).

se ka thënë: "I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem urdhëroi një burrë nga fisi Eslem që të thërriste me zë të lartë: "Kush ka ngrënë, të agjërojë pjesën e mbetur të ditës dhe kush nuk ka ngrënë, le të agjërojë sepse sot është dita e Ashures."^[10]

Siç shihet, agjërimi i ditës së Ashures ka qenë obligim, por ai u abrogua. Ata u urdhëruan që të ndalen nga ushqimi nëse kishin ngrënë dhe të plotësonin agjërimin, i cili u llogaritej i saktë. Po kështu edhe me agjërimin e Ramazanit, sepse ai është obligim (ashtu siç ka qenë edhe agjërimi i ditës së Ashures) dhe gjykimi për atë që është obligim nuk ndryshon.

Hadithet për agjërimin e ditës së Ashures argumentojnë për disa gjëra:

a) agjërimi i ditës së Ashures ka qenë vaxhib (detyrë);

b) kush nuk e bën nijetin për agjërimin farz që me natë, nga mosdija e hyrjes së Ramazanit, agjërimi nuk i priset;

c) ai që ka ngrënë e ka pirë, pastaj mëson se ka hyrë Ramazani, duhet të agjërojë pjesën e mbetur dhe nuk e ka obligim ta përsërisë atë ditë.

3. KOHA E AGJËRIMIT

Shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në fillim të Islamit, kur vinte koha e iftarit dhe nëse kishin agjëruar, hanin, pinin dhe kryenin marrëdhënie me gratë e tyre, përderisa nuk kishin fjetur. E, nëse dikush nga ata flinte para ngrënies së darkës apo iftarit, nuk u lejohej më të bënë diçka nga këto që përmendëm më lart, deri të nesërmen. Më pas, Allahu ua lehtësoi dhe ata u gëzuan shumë. Këtë e bën të qartë edhe hadithi në vijim:

Transmetohet nga El Bera, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: "Nëse dikush prej shokëve të Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishte agjërueshëm, pastaj vinte koha e iftarit dhe ngrihej pa ngrënë, atëherë nuk hante më atë natë deri të nesërmen në mbrëmje. Një herë, Kajs ibën Sirme el Ensari ishte agjërueshëm dhe kur erdhi koha e iftarit, shkoi te gruaja e tij dhe i tha: -A të ndodhet ndonjë gjë për të ngrënë? -Jo, tha ajo, por mund të shkoj të kërkoj diku.

Por ngaqë tërë ditën punonte, e zuri gjumi dhe kur ajo erdhi dhe e pa ashtu, tha: "Ah, që mbete pa ngrënë!" Të nesërmen në mesditë atij i ra të fikët dhe këtë gjë ia treguan të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Atëherë u shpall ajeti: "**Ju është bërë e ligjshme që të kenë marrëdhënie me gratë tuaja netët e agjërimit.**"

Ata u gëzuan shumë me këtë ajet. Pastaj zbriti pjesa tjetër e ajetit: "**Hani e pini derisa të dallohet peri i bardhë (drita e agimit) nga peri i zi (errësira e natës).**" Bekare: 187^[11]

Pikërisht kjo ka përcaktuar kufijtë e ditës së agjërimit; fillimin dhe mbarimin e saj; që nga dallimi i agimit deri në mbarim të ditës dhe në hyrje të natës, kur rrethi i diellit mbulohet nën horizont.

1. Peri i bardhë dhe peri i zi.

Kur zbriti ajeti që përmendëm më lart, disa nga shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem morën fije të zeza dhe fije të bardha dhe i vendosën nën jastëk apo i lidhën në këmbë. Pastaj vazhdonin të hanin e të pinin derisa të mund t'i dallonin ata nga njëritjetri.

Adij ibën Hatimi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: "Kur ka zbritur ky ajet: "**hani e pini**

[10] Transmeton Buhariu (4/216) dhe Muslimi (1135).

[11] Transmeton Buhariu (4/911).

derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi në agim" Bekare: 187, unë mora një pe të zi dhe një të bardhë dhe i vendosa nën jastëkun tim. Gjatë natës i vështroja me qëllim që t'i dalloja nga njëri-tjetri, por nuk i dallova dot, kështu që shkova tek i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe i thashë për këtë. Ai tha: *"Në ajet është për qëllim errësira e natës dhe drita e ditës."*^[12]

Shehël ibën Seadi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: "Kur zbriti ky ajet: "Hani e pini derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi", ai që donte të agjëronte lidhte në këmbën e tij një fije peri të bardhë dhe një të zezë dhe vazhdonte të hante dhe të pinte derisa qartësohej shikimi i tyre. Atëherë Allahu shpallin ajetin: "në agim" dhe e kuptuan pastaj se qëllimi ishte për ditën dhe natën."^[13]

Këtë e ka sqaruar edhe i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem kur u ka sqaruar shokëve të tij kufirin e dallimit të ditës nga nata, me një përskrim pas të cilit nuk mbetet më asnjë pikë dyshimi apo mosnjohje në këtë çështje.

2. Janë dy agime

Prej dispozitave që ka sqaruar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është edhe fakti se agimi është dy llojesh, apo se kemi dy agime:

- agimi mashtrues, i remë: i cili nuk e bën të lejuar faljen e namazit të sabahut dhe as nuk e ndalon agjëruesin nga ushqimi;
- agimi i vërtetë: i cili ia ndalon ushqimin agjëruesit dhe e bën të lejuar faljen e sabahut. Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Janë dy agime, i pari nuk*

e bën të ndaluar ushqimin dhe as nuk e bën të lejuar namazin (e sabahut), ndërsa i dyti e bën të ndaluar ushqimin dhe e bën të lejuar namazin (e sabahut)."^[14]

Dije, vëlla musliman, se:

- agimi mashtrues është e bardha e shtrirë dhe ndriçuese, që ngrihet në qiell si bishti i ujkut;
- agimi i vërtetë është ngjyra e kuqe që përhapet gjerësisht në fusha e kodra, që shpërndahet nëpër rrugë e shtëpi. Ky është ai me të cilin lidhen dispozitat e agjëritit dhe të namazit.

Semurete, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Të mos ju mashtrojë ezani i Bilalit e as kjo bardhësi që zgjatet në agim derisa të përhapet horizontalisht."*^[15]

Talk ibën Ali transmeton se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Hani dhe pini e të mos ju mashtrojë drita e bardhë që ngjitet në qiell vertikalisht (para agimit), por hani e pini derisa t'ju zërë drita e kuqe."*^[16]

Dije se cilësitë e agimit të vërtetë janë ato që përputhen me ajetin e Kur'anit: **"...derisa të dallohet qartë peri i bardhë nga peri i zi në agim"** Bekare: 187. Pra, drita e agimit të vërtetë është ajo që përhapet horizontalisht nëpër lugina dhe majat e kodrave si të ishte fije peri e bardhë, ndërsa sipër saj shfaqet fija e zezë nga mbetjet e errësirës që është duke u larguar.

Nëse e dallon këtë dritë, atëherë ndalu nga ngrënia e pirja dhe nga marrëdhëniet intime. E nëse ke në dorë një gotë ujë apo pije tjetër, pije atë dhe të bëftë mirë sepse është një lejim madhështor nga më i Madhi i mëshiruesve për robërit e Tij agjërues. Dhe nëse e dëgjon

[12] Transmeton Buhariu (4/113) dhe Muslimi (1090).

[13] Transmeton Buhariu (4/114) dhe Muslimi (1091).

[14] Transmeton Ibën Huzejme (3/210), Hakim (1/191 dhe 495), Darekutni (2/165), Bejhaki (4/261), Hakimi (1/191), Bejhakiu (4/215) dhe Darekutni (2/165).

[15] Transmeton Muslimi (1094).

[16] Transmeton Tirmidhiu (3/76), Ebu Davudi (2/304), Ahmedi (4/23), Ibën Huzejme (3/211); nga Abdullah ibën Neumani, nga Kajs ibën Talku, nga babai i tij, me zinxhir të saktë.

ezanin, Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Nëse dikush prej jush dëgjon ezanin dhe në dorën e tij ka enë me ushqim apo pije, mos ta lërë atë derisa të marrë nevojën që ka prej saj."*^[17]

Qëllimi me ezanin është ezani i dytë i agimit të vërtetë dhe argument për këtë është edhe shtojca e hadithit, të cilën e ka transmetuar imam Ahmedi (2/510), Ibën Xherir et Taberi (2/102) e të tjerë, se në fund të hadithit thuhet: *"Dhe muezini e thërriste ezanin (e dytë) kur fillonte agimi."*

Për këtë çështje argumenton edhe ajo që transmeton Ebu Umamete, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, i cili thotë se: *"U thirr ikameti për namaz dhe Umeri kishte enën me ujë në dorë. -A të pi, o i Dërguari i Allahut? - Po, tha ai dhe Umeri e piu atë."*^[18]

Me këtë na vërtetohet se ndalesa e të ngrënit para fillimit të agimit të vërtetë është risi e shpikur.

Ibën Haxheri në "Fet'hul-Bari" (4/199) thotë: "Nga bidatet e urryera që janë shpikur në këtë kohë është thirrja e ezanit të dytë në muajin e Ramazanit njëzet minuta para agimit si dhe fikja e kandilave që janë vënë si shenjë për ndalimin nga të ngrënit dhe të pirit për atë që dëshiron të agjërojë, me pretekstin se kjo risi është për siguri në kryerjen e plotë të adhurimit. Por këtë gjë nuk e dinë veçse pak njerëz dhe ky pretekst i ka shtyrë ata që ta thërrasin ezanin e akshamit pas perëndimit të diellit me disa gradë, kur të ketë hyrë koha tamam, sipas tyre, duke e vonuar kështu iftarin dhe duke shpejtuar syfyryn, në kundërshtim me Sunetin. Për këtë shkak është pakësuar e mira tek ata dhe është shtuar e keqja. Allahu na ndihmoftë!"

Ka vazhduar ky bidat i ndalesës së të ngrënit para agimit të vërtetë dhe pritja e hyrjes me vonesë e kohës së namazit edhe në këtë kohën tonë. Tek Allahu ankohe mi!

3. Pastaj plotësohet agjërimi deri në mbrëmje
Nëse nata fillon nga ana e lindjes dhe dita mbaron nga perëndimi dhe dielli perëndon, atëherë duhet të hajë.

Transmetohet nga Umeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Nëse fillon nata nga kjo anë dhe mbaron dita nga ana tjetër dhe perëndon dielli, atëherë agjëruesi e prish agjërimin."*^[19]

Kjo gjë vërtetohet menjëherë pasi humb rrethi i diellit, edhe pse ndoshta drita e tij sipërfaqësisht duket. Nëse Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë agjërueshëm, ka urdhëruar një person që të ngjitet mbi një vend të lartë dhe të shikojë diellin; nëse ai ka thënë se ka perënduar, atëherë ka bërë iftar.^[20]

Disa njerëz supozojnë se nata nuk bie pas perëndimit të diellit menjëherë, por pasi shpërndahet errësira në lindje dhe në perëndim. Kjo ka ndodhur edhe me disa nga shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, por iu qartësua se mjafton që të bjerë errësira nga lindja menjëherë pasi të humbë rrumbullaku i diellit.

Abdullah ibën Ebi Evfa, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton e thotë: "Ishim me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në një udhëtim dhe ai ishte agjërueshëm (në muajin e Ramazanit). Kur perëndoi dielli, ai i tha njërit prej njerëzve: *"O flan!"*, ndërsa në një transmetim tjetër të Ebu Davudit thuhet: *"O Bilal! Na sill ujë."* Ai tha: *"O i*

[17] Transmeton Ebu Davud (235), Ibën Xherir (3115), el Hakimi (1/426), el Bejhakui (2/218), Ahmedi (2/423), me zinxhir të mirë.

[18] Transmeton Ibën Xheriri (2/102) nga dy rrugë transmetuesish.

[19] Transmeton Buhariu (4/171) dhe Muslimi (1100). Fjala e tij "e prish agjërimin"; d.m.th. sipas dispozitës e jo realisht, për atë se ka hyrë koha e iftarit.

[20] Transmeton el Hakimi (1/434) dhe Ibën Huzejme (2061).

Dërguari i Allahut! Sikur të prisje sa të ngryset?”, ndërsa në transmetimin tjetër shton: “Sa të perëndojë dielli?” Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: “Zbrit dhe na sill ujë!”

- Por është ende ditë- tha ai.

- Zbrit dhe na sill ujë!

Atëherë zbriti dhe u solli ujë, nga i cili piu edhe i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Thotë: *“Sikur ndokush të shihnte nga perëndimi i hipur mbi devenë e tij, do ta shihnte diellin (të paperënduar ende).”* Pastaj ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem bëri me shenjë me gishtin e tij nga lindja dhe tha: *“Nëse sheh se nata ka filluar nga kjo anë, atëherë agjëruesi bën iftar.”*^[21]

Është vërtetuar nga sahabët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem se ata e kanë pasuar këtë fjalë dhe është përshtatur vepra e tyre me fjalën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ebu Seid el Hudri, p.sh., ka vepruar kështu duke bërë iftar pasi ka perënduar apo ka humbur rrumbullaku i diellit.^[22]

Vërejtje: Dispozitat e agjërimit që u përmendën më herët kanë të bëjnë me shikimin e syrit (syrit të njeriut) dhe nuk duhet të mundohemi me mjetet teknike bashkëkohore për të dalluar kohën e mëngjesit apo përmes kalendarëve, të cilët i kanë larguar muslimanët nga tradita dhe mësimi i Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pasi tek ata e mira është e pakët ndërsa e keqja e shumtë. Allahu e di më së miri!

Vërejtje tjetër: Në disa vende muslimane për thirrjen e ezanit muezinët ndihmohen nga kalendarët, që botohen prej rreth pesëdhjetë vitesh. Ata e vonojnë iftarin dhe e shpejtojnë syfyryn, duke rënë kështu drejtpërsëdrejti në kundërshtim me udhëzimin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Në këto vende ngrihen disa nga ata që kujdesen për praktikimin e Sunetit dhe bëjnë iftar me perëndimin e diellit, ndërsa syfyryn e llogarisin me agimin. Kur perëndon dielli, ata hanë iftar dhe kur hyn agimi i vërtetë – siç e sqaruar më parë e fillojnë agjërimitin. Kjo vepër është një vepër e ligjshme dhe e saktë, për të cilën nuk ka pikë dyshimi. Ndërsa ai që mendon se ky gjest apo kjo vepër është gabim, ta dijë mirë se ka gabuar me një gabim shumë të qartë. Nuk ka ndryshim e fuqi veçse me Allahun!

Siç nuk mund të mos jetë e ditur, ky adhurim (agjërimiti) është i lidhur me perëndimin e diellit dhe me agimin e nëse këtë gjë e kundërshton dikush, ta dini se ata janë gabimtarë e jo ata që kapen pas bazës dhe përqendrohen në të. Ezani është lajmërim për hyrjen e kohës, por nëse koha ka hyrë dhe ezani vonohet apo ezani thirret para se të hyjë koha e caktuar, atëherë qëndrimi në origjinë është ajo që obligohet. Mësoje këtë dhe medito mirë!

4. SYFYRI

1. Urtësia e syfyrit

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem urdhëroi që të hahej syfyr në agim për të dalluar mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të librit.

Amër ibën Asi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të librit është ngrënia e syfyrit.”*^[23]

2. Dobitë e syfyrit

a) Ngrënia e syfyrit është bereqet

Transmetohet nga Selmani, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se i Dërguari i Allahut sal-

[21] Transmeton Buhariu (4/199), Muslimi (1101), Ahmedi (4381), Ebu Davud (2352).

[22] E transmeton Buhariu në shënimet e tij (mualek) (4/196). Gjithashtu e ka përmend edhe Ibën Ebi Shejbe në "el Musannef" (3/12) dhe Said ibën Mensur, siç thuhet në "el Fet'h" (4/196) dhe në "Umdetu el Karij" (9/130).

[23] Transmeton Muslimi (1096).

IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "*Bereqeti gjendet në tri gjëra: në të ngrënë bashkë, në të ngrënë e qullit dhe në të ngrënë e syfyrit.*"^[24]

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "*Me të vërtetë Allahu e ka vënë bereqetin në syfyr dhe në kandar.*"^[25]

b) Allahu fal dhe melekët e Tij bëjnë lutje për ata që hanë syfyr

Ebu Seid el Hudri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "*Ngrënia e syfyrit është bereqet, ndaj mos e lini atë qoftë edhe me pirjen e një gllënjë ujë, sepse Allahu i fal dhe melekët e Tij bëjnë lutje për ata që hanë syfyr.*"^[26]

3. Vonimi i syfyrit

Është e preferuar që syfyri të vonohet deri pak para faljes së sabahut, pasi i Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe Zejd ibën Thabiti, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, kanë ngrënë syfyr së bashku dhe kur e kanë mbaruar syfyrin, i Dërguari u ngrit dhe fali sabahun. Koha ndërmjet përfundimit të ngrënies së syfyrit të tyre dhe faljes së namazit ishte sa të lexuarit e pesëdhjetë ajeteve nga libri i Allahut. Siç është transmetuar nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Zejd ibën Thabiti, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: "Kemi bërë syfyr me të Dërguarin sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, pastaj ai u ngrit për të falur namazin (e sabahut)." I thashë (Enesi i tha Zejdit): "*Sa ka qenë koha mes ezanit dhe syfyrit?*" Tha: "*Sa të lexuarit e pesë-*

hjetë ajeteve."^[27]

Dije, o rob i Allahut, Allahu të drejtoftë në të vërtetën, se ty të lejohet ngrënia, pirja dhe kryerja e marrëdhënieve intime përderisa je në dyshim për agimin dhe nuk të është qartësuar ai, pasi Allahu i Lartësuar dhe i Dërguari i Tij sal-IAllahu alejhi ve sel-leme e kanë sqaruar kufirin e dallimit të ditës nga nata dhe ngase Allahu i Madhëruar e ka falur atë vepër që bëhet gabimisht dhe me harresë dhe e ka lejuar ngrënien, pirjen dhe marrëdhëniet derisa të qartësohesh. Dyshimi nuk është qartësi, pasi qartësia është gjë e sigurt dhe nuk ka dyshim në të; ndaj sigurohu!

4. Vendimi për syfyrin

I Dërguari i Allahut sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka urdhëruar me urdhër të prerë se kush dëshiron të agjërojë, të ngrihet dhe të bëjë syfyr.

Ai sal-IAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "*Kush dëshiron të agjërojë, atëherë le të ngrihet e të bëjë syfyr me diçka.*"^[28]

Shohim se urdhri i të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem është i përforcuar me përforcime të shumta nga tre drejtime:

a) urdhri për të;

b) fakti se ai është simbol i agjërimit të muslimanëve dhe ndarës, dallues mes agjërimit të tyre dhe agjërimit të të tjerëve;

c) ndalesa nga lënia e tij.

Këto janë fakte të forta dhe argumente të qarta.

Megjithatë, pas gjithë kësaj, Ibën Haxheri në "el Fet'h" (4/139) ka përcjellë faktin se dije-

[24] Transmeton Et Tabarani në "el Kebir" dhe Ebu Nuajm në "Dhikër Ehbar Esbahan" (1/57).

Senedi i tij është i mirë –hasen, nga hadithet që dëshmojnë për të.

[25] Transmeton esh Shirazi në "el Elkab", gjithashtu edhe në "Xhamiu Es Sagir" (1715) dhe el Hatib në "el Muvedih" (1/263).

[26] Nxjerrja e këtij hadithi është përmendur më parë.

[27] Transmeton Buhariu (4/118) dhe Muslimi (1097).

[28] E transmeton Ibën Ebi Shejbe (3/8), Ahmedi (3/367), Ebu Jeala (3/438) dhe El Bezar (1/465); nga Sherik ibën Abdullah ibën Muhamed ibën Akil nga Xhabiri. Sheriku është i dobët, por hadithi ka një dëshmuar tjetër mursal, nga Seid ibën Mensuri në "Sunenin" e tij, me shprehjen: "Bëni syfyr, qoftë edhe me një kafshatë."

Kështu ka thënë el Hafidh në "el Fet'h" (4/140). Hadithi ka edhe një dëshmitar tjetër, i cili do të vijë pas tre haditheve.

tarët janë të një mendimi (unanimisht – ixhma) se syfyri është vepër e preferuar dhe e pëlqyer! Allahu e di më së miri.

5. GJËRAT QË LEJOHEN PËR AGJËRUESIN

1. *Agjëruesi mund të gdhahet i papastër (xhunub)*

Ka pasur raste kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është gdhirë i papastër nga marrëdhëniet intime që ka pasur me gratë e tij, pastaj ka marrë gusël pas agimit dhe ka agjëruar.

Aishja dhe Umu Selemete, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, transmetojnë se *"kishte raste që të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e zinte sabahu duke qenë xhunub nga marrëdhëniet që kishte me gruan e tij, pastaj lahej dhe agjëronte."*^[29]

2. *Agjëruesit i lejohet të përdorë misvakun*

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Sikur të mos e rëndoja umetin tim, do ta urdhëroja që të përdorte misvakun në çdo abdest."*^[30]

Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem nuk e ka veçuar agjëruesin nga të tjerët dhe ky është argument se misvaku përdoret si nga agjëruesi edhe nga të tjerët, në çdo abdest dhe në çdo namaz.^[31]

Gjithashtu, ky hadith është i përgjithshëm për çdo kohë; para mesditës apo pas saj, e Allahu e di më së miri.

3. *Shpëlarja e gojës dhe e hundës*

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e shpëlante gojën dhe hundën duke qenë

agjërueshëm, mirëpo e ka ndaluar agjëruesin nga të tepruarit në këtë gjë.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"... dhe thithe mirë ujin me hundë, vetëm nëse je agjërueshëm."*^[32]

4. *Përqaftimi dhe puthja e bashkëshortes*

Aishja, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, transmeton se *"i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e puthte gruan duke qenë agjërueshëm si dhe e përqaftonte atë duke qenë agjërueshëm, por ai ka qenë më i përmbajtur se ju në epsheet e tij."*^[33]

Kjo gjë nuk është e preferuar për të riun, ndryshe nga i kaluari në moshë, sepse transmetohet nga Abdullah ibën Amër ibën Asi se ka thënë: *"Ndërsa ishim tek i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem aty erdhi një djalë i ri dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! A më lejohet ta puth gruan duke qenë agjërueshëm? Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "Jo." Pastaj erdhi një i moshuar dhe tha: "A më lejohet ta puth gruan duke qenë agjërueshëm?" I tha "Po." Atëherë ne po shihnim njëri-tjetrin me habi, ndërsa i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: "I moshuari e sundon veten e tij."*^[34]

5. *Analizat e gjakut dhe injeksionet joushqyese*

Këto nuk janë prej gjërave që e prishin agjërimin.

Për këtë do të flasim më pas në mënyrë të shtjelluar.

6. *Hixhamja*

Hixhamja, apo nxjerrja e gjakut me kupa, ka qenë prej gjërave që e prishnin agjërimin, por

[29] Transmeton Buhariu (4/123) dhe Muslimi (1109).

[30] Transmeton Buhariu (2/311) dhe Muslimi (252).

[31] Kjo është zgjedhja e Buhariut, gjithashtu edhe e Ibën Huzejmes dhe e të tjerëve. Shih: "Fet'hul Bari" (4/158), "Sahih Ibën Huzejme" (3/247) dhe "Sherhus Sunneh" (6/298).

[32] Transmeton Tirmidhiu (3/146), Ebu Davudi (2/308), Ahmedi (4/32), Ibën Ebi Shejbe (3/101), Ibën Maxhe (407) dhe Nesai (nr, 87) nga Lakit ibën Sabra, me zinxhir të saktë.

[33] Transmeton Buhariu (4/131) dhe Muslimi (1106).

[34] Transmeton Ahmedi (2/185,221); hadithi me një rrugë tjetër, të cilin e transmeton Taberani, ngrihet në gradën hasen- i mirë.

më pas kjo u abrogua, pasi është vërtetuar se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka bërë hixhamen duke qenë agjërueshëm, siç është transmetuar nga Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se *"i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka bërë hixhamen duke qenë agjërueshëm."*^[35]

7. Të provuarit apo të shijuarit e ushqimit

Por kjo është e kushhtëzuar me mosfutjen e tij në fyt, duke u bazuar në transmetimin e Ibën Ekvas, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ku thuhet: *"Nuk ka problem për agjëruesin nëse shijon uthullën apo diçka tjetër, por pa e futur deri në fyt."*^[36]

8. *Lyerja e syve, futja e pikave të ilaçit në to apo të ngjashme me to nga gjërat që hyjnë në sy*
Këto gjëra nuk e prishin agjërimit, pa marrë parasysh se a shijon diçka në fyt apo jo. Ky është mendimi që ka zgjedhur edhe hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, në librin e tij "E vërteta e agjërimit", si dhe nxënësi i tij, Ibën Kajjim el Xhevzije, në librin e tij "Zadul Mead". Ndërsa imam Buhariu, në "Sahihun" e tij thotë: "Enesi, Haseni dhe Ibrahim nuk shihnin ndonjë problem për agjëruesin nga lyerja e syve me kohël."

9. Hedhja e ujit të ftohtë mbi kokë dhe bërja banjë

El Buhari në "Sahihin" e tij,^[37] në temën "Bërja banjë për agjëruesin" thotë: "Ibën Umeri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, njomi një rrobë me ujë dhe e hodhi mbi kokë (a mbi shpinë) duke qenë se ishte agjërueshëm. Po kështu edhe Shebiu ka hyrë dhe ka bërë

banjë duke qenë agjërueshëm. Ndërsa Haseni ka thënë: Nuk ka problem për agjëruesin që të fusë ujë në gojë gjatë abdestit apo që të freskohet."

Madje edhe vetë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka hedhur ujë mbi kokën e tij nga etja apo nga vapa, kur ka qenë agjërueshëm."^[38]

6. ALLAHU DËSHIRON LEHTËSIM PËR JU E NUK DËSHIRON VËSHTIRËSIM

1. Udhëtari

Janë transmetuar hadithe të sakta ku udhëtarit i është dhënë të zgjedhë nëse dëshiron të agjërojë apo jo, pa harruar se kjo Mëshirë e Allahut është përmendur gjithashtu në Librin Famëlartë, ku i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti, thotë: **"E kush është i sëmure ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju e nuk dëshiron vështirësim për ju."** Bekare: 185

Hamza ibën Amër el Eslemi, i cili agjëronte vazhdimisht, e pyeti të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"A të agjëroj kur jam në udhëtim?"* I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i tha: *"Nëse do, agjëro e nëse do, mos agjëro."*^[39]

Enes ibën Maliku, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka thënë: *"Unë isha duke udhëtuar me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem gjatë Ramazanit dhe ata që agjëronin nuk i fajësonin ata që nuk agjëronin dhe as ata që nuk agjëronin nuk i fajësonin ata që agjëronin."*^[40]

Hadithet e mësipërme argumentojnë për

[35] Transmeton Buhariu (4/155). Shih gjithashtu: "Nasih el Hadith ve mensuhhi" (334-338), të Ibën Shahinit.

[36] E transmeton Buhariu në shënimet e tij (mualek), (4/154- Fet'h). Ndërsa Ibën Ebi Shejbe e ka transmetuar me zinxhir të rregullt në (3/47). Po kështu edhe el Bejhaki (4/261); nga dy rrugë transmetimi; nga ai (Ibën Abasi). Hadithi është i mirë.

[37] Shih burimet e mësipërme.

[38] Transmeton Ebu Daudi (2365) dhe Ahmedi (5/376, 380, 408, 430) me zinxhir të saktë.

[39] Transmeton Buhariu (4/156) dhe Muslimi (1121).

[40] Transmeton Buhariu (4/163) dhe Muslimi (1118).

përzgjedhjen e agjërimit apo lënies së tij nga udhëtari dhe nuk argumentojnë për preferencën e ndonjëres prej të dyjave. Mirëpo prej hadithit vijues ne mund të deduktojmë se është më mirë që gjatë udhëtimit të mos agjërohet. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Vërtet, Allahu dëshiron që të kryhen lehtësimet e Tij ashtu siç urren të kryhen mëkatet ndaj Tij."*^[41]

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: *"...ashtu siç dëshiron vendosmërinë në kryerjen e urdhrave të Tij."*^[42]

Por kjo mund të kufizohet tek ai person i cili nuk gjen vështirësi në agjërim, me qëllim që të mos kthehet lehtësimi për të pa u vërtetuar qëllimi i tij (i lehtësimit). Këtë gjë e ka qartësuar me një qartësim që nuk lë vend për dyshim, Ebu Seid el Hudri, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, i cili thotë: "Ata (sahabët) shihnin; nëse ndiheshin të fortë për të agjëruar, ashtu bënin, por nëse ndiheshin të dobët, nuk agjëronin dhe që të dyja ishin të mira."^[43]

Mirëpo nëse agjërimi në udhëtim është i vështirë për udhëtarin, kjo nuk është assesi nga mirësia dhe prishja është më primare dhe më e dashur për Allahun. Argument për këtë kemi atë që është transmetuar prej disa sahabëve, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre, se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Agjërimi në udhëtim nuk është nga mirësia (nga vepra e mirë)."*^[44]

2. I sëmuri

Allahu i Lartësuar e ka bërë të lejuar prishjen e agjërimit për të sëmurin, si mëshirë dhe lehtësim për të. Por duhet pasur parasysh se së-

mundja e cila e lejon prishjen e agjërimit është ajo që nëse bashkohet me agjërimin, e dëmton shëndetin dhe shtohet edhe më shumë, apo ajo e cila vonon shërimin. Allahu e di më mirë.

3. Gruaja me periudha dhe gruaja lehonë

Dijetarët janë pajtuar unanimisht se agjërimi nuk është i lejuar për gruan e cila është në periudhën e menstruacioneve dhe as për gruan lehonë. Ato duhet ta ndërpresin agjërimin dhe ta kompensojnë atë më vonë. Edhe nëse ato agjërojnë, ai nuk u quhet atyre (është i pavlefshëm).

4. Burri dhe gruaja e kaluar në moshë

Ibën Abasi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: "Burri i moshuar dhe gruaja e moshuar nuk kanë mundësi agjërimi, por ato japin lëmoshë duke ushqyer një të varfër për çdo ditë."^[45]

Ndërsa Darekutni (2/207) ka përcjellë dhe e ka quajtur të saktë një hadith nga Ibën Mensuri, nga Muxhahidi, nga Ibën Abasi, se ky ka lexuar ajetin: **"E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfri."** Bekare: 184

Pastaj tha: "Është për qëllim burri i moshuar, i cili nuk ka mundësi të agjërojë, kështu që i lejohet ta prishë agjërimin dhe të japë lëmoshë duke ushqyer për çdo ditë nga një të varfër; gjysmë tasi drithë."^[46]

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton dhe thotë: *"Këdo që e zë pleqëria dhe nuk është në gjendje të agjërojë në Ra-*

[41] Transmeton Ahmedi (2/108) dhe Ibën Hibani (2742) nga Ibën Omeri, me zinxhir të saktë.

[42] Transmeton Ibën Hibani (345), el Bezari (990) dhe et Tabarani në "El Kebir" (11881) nga Ibën Abasi, me zinxhir të vërtetë.

[43] Transmeton Tirmidhiu (713) dhe el Begaviju (1763) me zinxhir të vërtetë, edhe pse në të gjendet el Xhurejri, pasi transmetimet e Abdul A'la nga ai llogariten nga transmetimet më të vërteta, siç ka thënë edhe el Ixhlju e të tjerë.

[44] Transmeton Buhariu (4/161) dhe Muslimi (1115) nga Xhabiri.

[45] Transmeton Buhariu (4505). Shih: "Sherh es Sune" (6/316), "Fet'hul Bari" (8/180), "Nejlul Eutar" (4/315) dhe "Irvaul Galil" (4/22-25).

Ndërsa Ibën el Mundhir në "el Ixhma" (nr. 129) ka përcjellë se janë unanimitë për këtë.

[46] Shih transmetimin para këtij.

mazan, atëherë për secilën ditë ai duhet të japë një mudd (dy grushte) grurë."^[47]

Enes ibën Maliku, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se "një vit ai u ndje i dobët dhe i paaftë për të agjëruar Ramazanin. Atëherë përgatiti një kazan me qull dhe ftoi tridhjetë të varfër, të cilët i ngopi mirë."^[48]

5. Gruaja shtatzënë dhe gruaja gjdhënëse

Transmetohet nga Enes ibën Maliku^[49] se ka thënë: "Kujt e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem erdhën drejt nesh me furi dhe unë shkova tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të cilin e gjeta duke ngrënë. Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"Afrohu dhe ha."* Unë thashë: *"Unë jam agjërueshëm."* Ai sal-lAllahu alejhi ve sel-lem tha: *"Afrohu, të të tregoj për agjërimin. Vërtet, Allahu e ka shkurtuar namazin përgjysmë për udhëtarin dhe e ka larguar barrën e të agjëruarit nga gruaja shtatzënë dhe gruaja gjdhënëse"* Për Zotin! I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e tha këtë për të gjithë këta. Atëherë, si të mos e ha ushqimin e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?!"^[50]

7. IFTARI

1. Kur bën iftar agjëruesi?

Allahu i Lartësuar thotë: **"...pastaj plotësojeni agjërimin deri në mbrëmje."** Bekare: 187

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e ka komentuar këtë ajet me ardhjen e natës, ikjen e ditës dhe humbjen e rrumbullakut të diellit, siç e sqaruam më parë.

Transmeton Abdurrezaku në "el Musanaf"

(7591) me zinxhir transmetuesish të cilin e ka vërtetuar el Hafidh në "el Fet'h" (4/199). El Hejthemi në "Mexhma el Zevaid" (3/154), nga Amër ibën Mejmun el Advij, thotë: "Shokët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ishin më të shpejtët në çeljen e iftarit dhe më të vonuarit në sifyr."

2. Shpejtimi i iftarit

O vëlla besimtar, nxito për iftar posa të perëndojë dielli dhe mos i hidh sytë në të kuqërremtën e ndezur që duket në horizont, sepse ajo nuk merret në konsideratë për kohën e iftarit. Në veprimin e kësaj ti je pasues i të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe kundërshtues i çifutëve e të krishterëve, të cilët e vonojnë iftarin deri në një afat të caktuar, që është shfaqja e yllit. Këtë e sqarojnë fare qartë hadithet e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në paragrafët në vijim:

a) Shpejtimi i iftarit është mirësi

Sehël ibën Seadi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit do të vazhdojnë të jenë mirë përderisa e shpejtojnë iftarin."*^[51]

b) Shpejtimi i iftarit është Suneti i të Dërguarit të Allahut

Sehël ibën Seadi, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Populli im do të vazhdojë të jetë mirë përderisa nuk do të presë shfaqjen e yjeve për të bërë iftar."*^[52]

c) Shpejtimi i iftarit është kundërshtim i

[47] E transmeton Darakutni (2/208), por në zinxhirin e tij gjendet Abdullah ibën Salih, i cili është i dobët, porse ka dëshmuar që e përforcojnë këtë hadith.

[48] Transmeton Darakutni (2/207) me zinxhir të vërtetë.

[49] Ky është Enes ibën Malik el Keabiju, jo Enes ibën Malik el Ensari, shërbëtori i Muhamedit alejhi selam. Ky është nga fisi beni Abdullah ibën Keab, i cili ka banuar në Basra, ka transmetuar nga Muhamedi alejhi selam vetëm një hadith dhe ky është ai hadith. Shiko "el Isabetu" (1/114-115), të Ibën Haxheri dhe "Texhrid esamu Sahabeti" (1/31) të Dhehebiut.

[50] Transmeton Tirmidhiu (715), Nesai (4/180), Ebu Davudi (2408) dhe Ibën Maxhe (1667). Senedi i tij është hasen- i mirë, ashtu siç ka thënë Tirmidhiu.

[51] Transmeton Buhariu (4/173) dhe Muslimi (1093).

[52] E transmeton Ibën Hibani (891), me zinxhir të saktë.

atyre me të cilët Allahu u hidhërua dhe kundërshtim i të humburve Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Feja do të vazhdojë të jetë triumfuese përderisa njerëzit e shpejtojnë iftarin, për atë se çifutët dhe të krishterët e vonojnë atë."*^[53]

ç) Bërja iftar para faljes së namazit të akshamit

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem bënte iftar para se të falej,^[54] pasi shpejtimi i iftarit është nga morali i Pejgamberëve. Transmetohet nga Ebi Derda, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: *"Tri gjëra janë nga morali pejgamberik; shpejtimi i iftarit, vonimi i syfyrit dhe vendosja e dorës së djathtë mbi të majtën në namaz."*^[55]

3. Me çfarë bëhet iftari?

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem nxiste gjithnjë që agjërimi të çelej me hurma (arabe). Por nëse nuk gjen, atëherë me ujë. Kur trupit i jep diçka të ëmbël ndërkohë që stomaku është bosh, ai e pranon më lehtë dhe dobia e tij është më e madhe për gjymtyrët, veçanërisht për trupin e shëndetshëm (të pasëmurë), sepse merr fuqi me të. Ndërsa uji; pasi trupi ka humbur lëngje gjatë ditës dhe kur atij i futet ujë, ai ka më shumë dobi nga ushqimi.

Transmetohet nga Enes ibën Maliku, Allahu

qoftë i kënaqur prej tij, se ka thënë: *"I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem e çelte iftarin me disa rutab (hurmë e njomë) para se të falej. E, nëse nuk gjente rutab, atëherë e çelte me temër (hurmë e thatë), e nëse nuk gjente temër, atëherë pinte disa gllënjka ujë."*^[56]

4. Çfarë thuhet kur ha iftar?

Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Tre personave nuk u refuzohet lutja; agjëruesit kur bën iftar, udhëheqësit të drejtë dhe atij që i është bërë padrejtësi."*^[57]

Abdullah ibën Amër ibën Asi thotë: "I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Me të vërtetë, për agjëruesin në kohën e iftarit ka dua që nuk refuzohet."*^[58]

Ndërsa duaja më e mirë është ajo që është përcjellë nga i Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i cili kur bënte iftar thoshte: *"Dhehebe edh-dhameu veb-teletil-uruku ve thebetel-exhru insha-Allah!"*

"Kaloi etja, u lagën damarët, dhe u arrit shpërblimi inshallah"^[59]

5. Dhënia iftar agjëruesit

I Dërguari i Allahut sal-lallahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Kush i bën iftar një agjëruesi, ai ka shpërblim si ai që ka agjëruar duke mos pakësuar nga shpërblimi i agjëruesit asgjë."*^[60]

E nëse muslimani agjërues ftohet për iftar, ai e ka obligim t'i përgjigjet ftesës, kurse ai që

[53] Transmeton Ebu Davudi (2/305) dhe Ibën Hibani (224), me zinxhir të mirë.

[54] Transmeton Ahmedi (3/164) dhe Ebu Davudi (2356); nga Enesi, me zinxhir të mirë.

[55] Transmeton Tabarani në "el Kebir" dhe ka thënë: "...ky hadith është përcjellë edhe i ngritur tek i Dërguari alejhi selam, edhe si fjalë e Ebu Dardasë, por si fjalë e Ebu Dardasë është e saktë, ndërsa si i ngritur, në senedin e tij gjenden transmetues të cilëve nuk u kam gjetur biografi." Them: Megjithatë, edhe transmetimi i ngelur te Ebu Darda merr gjykimin e hadithit të ngritur te i Dërguari, në këtë rast.

[56] Transmeton Ahmedi (3/163), Ebu Davudi (2/306), Ibën Huzejme (3/277,278) dhe Tirmidhiu (3/70) nga dy rrugë transmetimi, nga Enesi. Senedi i tij është i saktë.

[57] Transmeton Tirmidhiu (2527), Ibën Maxhe (1752) dhe Ibën Hibani (2407), por në mesin e transmetuesve të tij gjendet Ebu Mudile, i cili nuk është i njohur plotësisht.

[58] Transmeton Ibën Maxhe (1/557), el Hakim (1/442), Ibën Es Sunni (128), dhe Et Tajalisi (299) nga dy rrugë transmetimi. El Busiri thotë (2/81):

"Zinxhiri i këtij hadithi është i saktë dhe transmetuesit e tij janë të besueshëm."

[59] Transmeton Ebu Davudi (2/306), el Bejhakui (4/239), el Hakim (1/442), Ibën Es Sunni (128), Nesai në "Amel el Jevm e el-lejleti" (269), Darakutni (2/185), i cili thotë se zinxhiri i tij është i mirë.

[60] Transmeton Ahmedi (4/114-115-116, 5/192), Tirmidhiu (804), Ibën Maxhe (1746) dhe Ibën Hibani (895). Tirmidhiu e ka konsideruar të saktë dhe ai është ashtu siç ka thënë.

nuk i përgjigjet ftesës ka thyer urdhrin e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Agjëruesi duhet të jetë i bindur se bërja e iftarit të dikush tjetër që e fton atë nuk ia pakëson atij shpërblimin dhe të mirat e tij.

8. GJËRAT QË E PRISHIN AGJËRIMIN
Ekzistojnë disa gjëra të cilave agjëruesi duhet t'u largohet kur agjëron. Nëse i bën ato gjatë ditës në Ramazan, agjërimi i tij konsiderohet i prishur dhe ai merr gjynahe. Këto gjëra po i përmendim në vijim:

1. Ngrënia dhe pirja me vetëdije e jo me harresë

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "Nëse ha dhe pi nga harresa, atëherë plotësoje agjërimin, sepse Allahu është Ai i Cili të ka ushqyer dhe të ka dhënë për të pirë."^[61]

2. Të vjellët me qëllim

Çështja është ndryshe për atë që e mund e vjella, pasi atij nuk i prishet agjërimi. I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: "Nëse ndokënd e mund e vjella, ai nuk e ka obligim që ta kompensojë atë ditë, ndërsa kush vjell qëllimisht (duke futur gishtat a me ndonjë mënyrë tjetër), ai duhet ta kompensojë atë ditë me një ditë tjetër (më pas)."^[62]

3. Menstruacionet dhe lehonja

Nëse gruas i fillojnë menstruacionet apo gjakderdhja e paslindjes në çfarëdo kohe gjatë ditës së Ramazanit, pa marrë parasysh

se a është në fillim apo në mbarim të ditës, agjërimi i saj është i prishur dhe ajo duhet t'i kompensojë atë ditë sa ka prishur në një kohë tjetër, pasi të përfundojë muaji. Nëse ajo vendos që ta vazhdojë agjërimin, ai nuk do të jetë i vlefshëm.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: "A nuk është ajo që nëse asaj i fillojnë menstruacionet, ajo as nuk falet, as nuk agjëron?" Ato thanë: "Po." Ai, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, tha: "Pikërisht kjo është mangësia në fenë e saj."^[63]

Urdhri për kompensim ka ardhur në hadithin e përcjellë nga Muadhetu, e cila e ka pyetur Aishen: "Përse gruaja që ka menstruacione duhet ta kompensojë agjërimin që i humb, ndërsa namazin nuk duhet ta kompensojë?" Ajo u përgjigj: "A je ti nga harurijet?"^[64] Tha: "Jo, nuk jam harurije, por thjesht po pyes." Aishja tha: "Na ndodhte edhe neve një gjendje e tillë (në kohën e të Dërguarit alejhi selam) dhe ne urdhëroheshim që ta kompensojmë agjërimin, kurse namazin jo."^[65]

4. Injeksionet ushqyese

Fjala është për futjen e disa lëndëve ushqyese në trup me qëllim ushqyerjen e disa të sëmurëve. Këto gjilpëra ushqyese apo serume e prishin agjërimin, pasi e depërtojnë ushqimin në brendësi të trupit.^[66] Edhe nëse lënda ushqyese nuk arrin në stomak, por arrin në gjak, edhe kjo e prish agjërimin, pasi kthehet në vend të ushqimit dhe pirjes. Shumë të sëmurë që humbin vetëdijen ushqehen për një kohë të gjatë me këto lloj injeksionesh, si

[61] Transmeton Buhariu (4/135) dhe Muslimi (1155).

[62] Transmeton Ebu Davudi (2/310), Tirmidhiu (3/79), Ibën Maxhe (1/536) dhe Ahmedi (2/498). Senedi i tij është i saktë, siç ka thënë hoxxa i Islamit Ibën Tejmije në "Hakikatu es Sijam" (faqe 14).

[63] Transmeton Muslim (79) dhe (80) nga Ibën Omeri dhe nga Ebu Hurejra.

[64] Harurij është banori i Haruras, vend dy milje larg Kufës. Por përdoret gjithashtu emërtimi "haruri" për atë që ka bindje të havarixhëve, pasi grupimi i parë që ngriti krye kundër Aliut, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, ka qenë prej tyre, kështu që u emërtuan me atë emër. Këtë e ka thënë El Hafidh në "el Fet'h" (4/424). Këta haruritë e obligojnë femrën që është me menstruacione, që kur të pastrohet, t'i kompensojë namazet që i kanë kaluar gjatë kohës kur ka qenë në atë gjendje, ndaj u frikësua Aishja se mos Muadhja e kishte marrë këtë pyetje nga havarixhët, të cilët e kishin zakon që t'i kundërshtonin sunetet me mendjet e tyre. Edhe në kohën tonë kemi shumë prej këtyre!

[65] Transmeton Buhariu (4/429) dhe Muslimi (335).

[66] Shih: "Hakikatu es Sijam" (faqe 55) të Ibën Tejmijes.

glukozë dhe selajin.

Edhe lëndët që marrin disa të sëmurë me astmë e prishin agjërimin.

5. Marrëdhëniet seksuale

Shevkani në "ed Derari el Mudije" (2/22) thotë: "Nuk ka kundërshtim se marrëdhëniet intime e prishin agjërimin, nëse bëhen me vetëdije, mirëpo nëse ndodh nga harresa, disa nga dijetarët e kanë llogaritur njësoj si ngrënia dhe pirja nga harresa."

Ibën Kajjimi në "Zadul Mead" (2/60), thotë: "Kur'ani argumenton se marrëdhëniet janë prishëse të agjërimin, njësoj si ngrënia e pirja. Për këtë nuk ka kundërshtim."

Argument për këtë nga Kur'ani kemi fjalën e Allahut të Lartësuar: "**Tani pra, afrojuni atyre dhe kërkoni atë që Allahu ka përcaktuar për ju (fëmijë).**" Bekare: 187

Kush e prish agjërimin e tij me marrëdhënie seksuale, ai duhet të bëjë kompensim dhe shpajim për fajin. Argument për këtë është ajo që transmeton Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, nga i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ve sel-lem: "Një burrë erdhi dhe tha:

- O i Dërguari i Allahut! Unë u shkatërrova (mora fund)!

- Ç'të ka shkatërruar?

- Kam bërë marrëdhënie me gruan time në Ramazan.

- A ke mundësi të lirosh një rob?

- Jo.

- A je në gjendje të agjërosh dy muaj rresht?

- Jo.

- A je në gjendje të ushqesh gjashtëdhjetë të varfër?

- Jo.

- Ulu këtu!

Ai u ul. Më pas, dikush i solli të Dërguarit sal-Allahu alejhi ve sel-lem një kosh me hurma. Pejgamberi alejhi selam i tha (burrit që kishte kryer marrëdhënie në Ramazan):

- Jefe lëmoshë këtë.

- Nuk ka asnjë më të varfër se unë mes këtyre dy maleve.

Ai (transmetuesi) tha: "Atëherë i Dërguari sal-Allahu alejhi ve sel-lem qeshi sa iu dukën dhëmballët dhe tha: "Shko dhe ushqeje familjen tënde me to."^[67]

"Sifetu sevmi En Nebijji"
të Ali el Helbi dhe Selim Hilali
Përshtati:
Unejs Murati



[67] Ky hadith është transmetuar me shprehje të shumta nga Buhariu (11/516), Muslimi (1111), Tirmidhiu, (724), el Begavi (6/288), Ebi Davudi (2390), Ed Darimij (2/11), Ibën Maxheh (1671), Ibën Ebi Shejbe (2/183-184), Ibën Huzejme (3/216), Ibën Xharud (139), imam Shafiu (299), Maliku (1/297) dhe Abdurazaku (4/196). Shumica e tyre e kanë transmetuar me zinxhir të lidhur deri tek i Dërguari, kurse disa prej tyre e kanë transmetuar mursel. Disa e kanë parë të saktë shtesën: "Kompenso një ditë tjetër në vend të saj." Atë e ka saktësuar edhe el Hafidh ibën Haxher në "el Fer'h" (11/516) dhe ajo është ashtu siç ka thënë ai.

KËSHILLA E DIJETARIT BIN BAZ DREJTUAR MUSLIMANËVE PËR ARDHJEN E RAMAZANIT



Ikëshilloj dhe i porosis të gjithë muslimanët që t'i frikësohen Allahut të Lartësuar dhe ta presin këtë muaj të madh me pendim të sinqertë për të gjitha mëkatet e tyre dhe të mësojnë dhe të lexojnë për fenë e tyre, t'i mësojnë dispozitat e agjërimit dhe të namazit.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Kujt Allahu ia dëshiron të mirën, ia mundëson atij që të pajiset me dituri fetare.”^[1]

“Kur të vijë muaji Ramazan, hapen dyert e xhenetit, mbyllën dyert e zjarrit dhe lidhen shejtanët.”^[2]

“Kur të vijë nata e parë e muajit Ramazan, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllën dyert e xhebenemit, shejtanët lidhen me pranga dhe thërret një thirrës: “O kërkues i së mirës, nxito (nga ajo) dhe o kërkues i së ligës (mëkatit) ndalo (largohu nga ajo) dhe se Allahu për çdo natë liron njerëz nga zjarri i xhebenemit.”^[3]

Kur vinte ky muaj, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem u drejtohej shokëve të tij dhe u thoshte: *“Erdhi muaji i Ramazanit, muaji i bereqetit. Allahu i Lartësuar i begaton robërit e Tij, në këtë muaj zbret mëshirë, i shlyen mëkatet, u përgjigjet lutjeve, atëherë ngutuni në punë të mira, se vërtet fatkeq është ai i cili është i larguar nga rahmeti i Allahut.”*^[4]

Pra, ngutuni dhe shpejtoni për në vepra të mira dhe largojuni veprave të liga. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Kush e agjëron Ramazanin me besim (e bindje se Allahu është Ai që e ka bërë obligim agjërimin në këtë muaj) dhe llogari (se Allahu i Lartësuar është i vetmi Ai që di të shpërblejë për këtë), do t'i falen mëkatet e më-*

parshme. Kush ngrihet dhe fal namaz gjatë këtij muaji me besim dhe llogari, do t'i falen mëkatet e mëparshme të tij. Kush ngrihet dhe fal namaz Natën e Kadrit me besim dhe llogari do t'i falen mëkatet e mëparshme të tij.”^[5]

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Ka thënë Allahu i Lartësuar: “Të gjitha punët e birit të Ademit janë për të, e mira shumëfishohet për dhjetë e deri në shtatëqind të mira si ajo, përveç agjërimit; ai është për Mua dhe Unë di të shpërblej për të, ngase ai i ka lënë epshet, ushqimin dhe pirjen e tij vetëm për mua. Për agjëruesin janë dy gëzime: një gëzim kur ai bën iftar dhe një gëzim kur ai të takojë Zotin e tij. Era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa era e miskut.”*^[6]

Ai gjithashtu thotë: *“E kur të jetë ndonjëri prej jush agjërueshëm, nuk fol fjalë të ndyera dhe nuk bërtet. E nëse atë e fjen ose e sulmon ndokush, le të thotë: “Unë jam agjërues.”*^[7]

Dhe: *“Kush nuk e lë fjalën e rrejshme, të punuarit me të dhe injorancën, Allahu nuk ka nevojë për atë person që ta lërë ushqimin dhe pirjen e tij.”*^[8]

Prandaj, porosia ime për të gjithë muslimanët është që t'i frikësohen Allahut dhe ta ruajnë e ta mbrojnë agjërimin e tyre prej çdo mëkati. Le të fillojnë me punët e mira dhe le të nguten në to gjatë këtij muaji, të japin sadaka, të shtojnë leximin e Kur'anit, ta madhërojnë Allahun, ta falënderojnë Atë dhe të kërkojnë falje prej Tij, ngase ky muaj është muaji i Kur'anit. Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë: **“Muaji i Ramazanit është muaj që në të (filloi të) shpallet Kur'ani...”** Bekare: 185

[1] Transmeton Buhariu, nr: 71 dhe Muslimi, nr: 1037.

[2] Transmeton Buhariu, nr: 3277 dhe Muslimi, nr: 1079.

[3] Transmeton Tirmidhiu, nr: 682 dhe ibn Maxheh, nr: 1642.

[4] E ka përmendur Mundhiri në librin e tij et-Tergibu ve et-Terhib, nr: 1490.

[5] Transmeton Buhariu, nr: 1901 dhe Muslimi, nr: 760.

[6] Transmeton Buhariu 7492, Muslimi 1151, ibn Maxheh 1638.

[7] Transmeton Buhariu, nr: 1904.

[8] Transmeton Buhariu, nr: 1903.

Pra, është e pëlqyer që besimtarët të shtojnë leximin e Kur'anit ditën dhe natën, ngase në çdo shkronjë ka dhjetë sevape, duke e ditur se e mira shumëfishohet për dhjetë, siç na ka lajmëruar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, duke u kujdesur dhe larguar nga mëkatet, duke e këshilluar dhe porositur njëri-tjetrin për të mirë, duke urdhëruar për punë të mira dhe ndaluar nga e keqja. Muaji i Ramazanit është muaj i madh, në të shumëfishohen punët e mira, por rriten gjithashtu edhe punët e këqija dhe për besimtarin nuk mbetet tjetër vetëm se t'i kryejë ato punë për të cilat e ka ngarkuar Allahu i Lartësuar dhe të largohet prej asaj që Allahu e ka ndaluar dhe kujdesi i tij gjatë këtij muaji të jetë më i madh.

Për besimtarin është e pëlqyer që të mundohet të japë sadaka sa më shumë, të vizitojë të sëmurët, të përcjellë xhenazet, të vizitojë fafëfisnin e tij, të lexojë, të madhërojë Allahun, të bëjë tehlil (të thotë la ilahe il-lall-llah vahdehu la sherike leh lehu el-mulku ue lehu el-hamdu ue huve ala kulli shejin kadir) dhe të bëjë istigfar, të kërkojë falje prej Allahut dhe t'i lutet vetë Atij.

E lus Allahun e Madhërishëm që t'ua mundësojë besimtarëve të punojnë atë me të cilën Allahu i Lartmadhëruar është i kënaqur!

E lus Allahun që ta arrijmë këtë muaj, agjërimin dhe faljen gjatë këtij muaji me besim, bindje dhe llogari!

E lus Allahun që të na dhurojë dituri në fe dhe përqendrim në të e të na ruajë prej hidhërimit dhe dënimit të Tij, duke e lutur Atë gjithashtu që t'i forcojë të gjithë prijësit e muslimanëve, t'i udhëzojë ata dhe ta përmirësojë gjendjen e tyre, t'ua mundësojë atyre të gjykojnë me ligjin e Allahut të Madhërishëm në të gjitha çështjet, në lutjet, adhurimet dhe në të gjitha punët e tyre!

E lus Allahun që t'ua mundësojë atyre një gjë të tillë, si praktikim i fjalëve të Allahut: **"(Ta zbritëm) Që edhe ti të gjykojë me atë që të shpalli Allahu..."** Maide: 49

"A thua mos po kërkojnë gjykimin e kohës së injorancës, po për një popull që bindshëm beson, a ka gjykim më i mirë se ai i Allahut?" Maide: 50

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty e as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht." Nisa: 65

"O ju që besuat, bindjuni Allahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtroni atë tek Allahu (te libri i Tij) dhe tek i Dërguari,^[9] po qe se i besoni Allahut dhe Ditës së Fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë." Nisa: 59

"Thuaj: "Respektoni Allahun, respektoni të Dërguarin!" En-Nure: 54

"Ç'ka t'ju japë Pejgamberi, atë merreni e ç'ka t'ju ndalojë, përmbajuni dhe kini frikë Allahun se Allahu është ndëshkues i ashpër." El-Hashr: 7

Pra, ky është obligim i të gjithë besimtarëve dhe i prijësve të tyre, është obligim për qeveritarët muslimanë, dijetarët e tyre dhe muslimanët në përgjithësi, që t'i frikësohen Allahut, që të punojnë sipas urdhrave të Tij dhe ta praktikojnë atë në mes tyre, ngase Ai e ka zbritur këtë fe, me të cilën përmirësohen e udhëzohen njerëzit dhe me të arrihet një përfundim i lumtur dhe i pëlqyer. Në këtë fe është kënaqësia e Allahut, në këtë fe gjen të vërtetën dhe me të largohesh prej zullumit dhe punëve të këqija.

Dhe në fund, e lusim Allahun e Madhërishëm që të na udhëzojë, të na përmirësojë nijetet dhe punët tona! Salatet dhe selamet qofshin për Pejgamberin tonë, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, mbi familjen dhe mbi shokët e tij!

Shkëputur nga "Mexhmu'u Fetava ue Mekalat Mutenvviah", të hoxhës së nderuar Abdulaziz Ibën Abdullah ibën Baz, Allahu e mëshiroftë!

Përshtati: Bali Musli Sadiku



[9] Te Suneti i tij (sh.p).